

## **ALBPETROL SHA**

Pasqyrat Financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2022

Së bashku me Raportin e Audituesit të Pavarur

# RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR

DREJTUAR: **MINISTRISË SË ENERGJISË DHE INDUSTRIË**  
**(AKSIONERIT TË VETËM)**

**KËSHILLIT MBIKËQYRËS TË SHOQËRISË "ALBPETROL" SHA**  
**ADMINISTRATORIT TË SHOQËRISË "ALBPETROL" SHA**

## Opinion me Rezervë

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të shoqërisë Albpetrol SHA (shoqëria), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar me datën 31 dhjetor 2022, pasqyrën e performancës dhe të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e fluksit të mjeteve monetare dhe pasqyrën e ndryshimeve në kapital për vitin e mbyllur në këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, me përjashtim të efekteve të çështjeve të përshkruara në paragrafin e bazës për opinionin me rezervë, pasqyrat financiare paraqesin në të gjitha aspektet materiale, në mënyrë të drejtë, pozicionin financiar të Albpetrol SHA me datën 31 dhjetor 2022, performancën e saj financiare dhe flukset e parasë për vitin e mbyllur në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).


## Baza për Opinionin me Rezervë

**1. Në shënimin 6**, në pasqyrën e pozicionit financiar më 31 Dhjetor 2022, paraqiten "Aktivet Afatgjata Materiale" me vlerën 30,928,906 mijë Lek ( 2021: 31,115,579 mijë Lek). Në zbatim të SNK 16 "*Aktivet Afatgjata Materiale (toka, ndërtesa, makineri e pajisje)*", shoqëria ka zgjedhur modelin e rivlerësimit për të matur vlerën e "Aktiveve Afatgjata " duke i paraqitur me vlerën e drejtë. Rivlerësimi kryhet në baza 3 deri në 5 vjet. Bazuar në kërkesat e SNK 36, një njësi ekonomike duhet të vlerësojë në çdo datë raportimi nëse ka apo jo ndonjë tregues që ndonjë aktiv të jetë i zhvlerësuar, nëse ekziston ndonjë tregues i tillë shoqëria duhet të çmojë shumën e rikuperueshme të aktivit. Shoqëria nuk ka kryer ndonjë test zhvlerësimi në zbatim të kërkesave të SNK 36. Ne nuk jemi në gjendje të përcaktojmë efektet e mundshme në pasqyrat financiare që do të kishte ky test zhvlerësimi.

Në zërin e aktiveve afatgjata materiale, kategoria e tokës nuk është e mbështetur në dokumentacion kadastral. Për këtë arsye, vlera e këtij zëri, në shumën 8,214,405 mijë Lek, nuk është pasqyruar në vlerën e kapitalit themeltar, por në zërin "*Prime të lidhura me kapitalin*" për të identifikuar këtë ngjarje. Në disa raste janë identifikuar diferenca në sipërfaqet e paraqitura në regjistrin e aktiveve afatgjata materiale me vlerën e paraqitur në certifikatat përkatëse të pronësisë, sikurse janë identifikuar raste të zënies së sipërfaqeve të tokave apo ndërtesave, ndërtime pa leje brenda sipërfaqeve të njësive, të cilat janë për ndjekje nga ana ligjore.

Në kategorinë "Ndërtesa" të zërit "*Aktive Afatgjata Materiale* ", për vlerën 344,365 mijë Lek (2021: 344,365 mijë Lek), përfshihet vlera e banesave të ndërtuara nga shoqëria, për të cilat shoqëria nuk disponon më të drejta pronësie, por i janë kaluar në pronësi Entit të Banesave. Në këto rrethana shoqëria duhet të zbatojë kërkesat e SNK 16, duke njohur vlerën prej 344,365 mijë Lek në pakësim të "Aktive Afatgjata Materiale ".

Standardi Ndërkombëtar i Kontabilitetit 12 "Tatimi mbi të ardhurat" kërkon që shoqëria të njohë tatime të shtyra, për diferencat midis vlerës kontabël neto të aktiveve afatgjata materiale të rivlerësuar dhe bazës tatimore. Shoqëria nuk ka llogaritur tatimin e shtyrë. Për sa më sipër, ne nuk jemi në gjendje të vlerësojmë efektin që kjo përlllogaritje do të kishte në pasqyrat financiare të shoqërisë në 31 Dhjetor 2022 dhe 2021.



**2. Në shënimin 9**, në pasqyrën e pozicionit financiar më 31 Dhjetor 2022, paraqiten "Inventarë" në vlerën 2,642,095 mijë Lek (2021: 2,937,812 mijë Lek). Për shkak se ne u emëruam si auditues në datën 20 Mars 2023, ne nuk ishim të pranishëm në procesin e inventarizimeve vjetore të cilat shoqëria i ka realizuar në periudhën Nëntor – Dhjetor 2022. Me gjithë procedurat alternative të zbatuara, për shkak edhe të natyrës së regjistrimeve të shoqërisë si edhe për shkak të mënyrës së ruajtjes së inventarëve, ne nuk mundëm të siguroheshim nëpërmjet evidencës të mjaftueshme dhe të përshtatshme në lidhje me sasinë e inventarit më datë 31.12.2022.

Gjithashtu, shoqëria ka në regjistrat e saj kontabël, inventarë jashtë përdorimit apo të papërdorshëm, për shkak të ndryshimeve në teknologji dhe vjetërsimit në kohë, në vlerën prej 1,281,197 mijë Lek, për të cilat shoqëria ka njohur zhvlerësime vetëm për vlerën 823,713 mijë Lek në periudha të mëparshme. Këto inventarë janë identifikuar, por nuk është realizuar përlogaritja dhe paraqitja e zhvlerësimit të plotë në datën e pasqyrave financiare më 31 Dhjetor 2022.

Sipas SNK 2 "Inventari" duhet të njihet për vlerën më të vogël ndërmjet kostos dhe vlerës neto të realizueshme. Si rrjedhojë, kur inventarët dëmtohen, janë bërë tërësisht ose pjesërisht të vjetërsuar ose nëse çmimet e shitjes së tyre kanë rënë nën kosto, shoqëria duhet të kryejë zhvlerësimin e inventarëve poshtë kostos deri në vlerën neto të realizueshme. Megjithëse ekzistonin të dhëna objektive që një pjesë e inventarit është i vjetërsuar apo i dëmtuar, shoqëria nuk ka bërë vlerësimin e vlerës neto të realizueshme të inventarit. Si rrjedhojë nuk jemi në gjendje të përcaktojmë efektet që këto vlerësime do të kishin në pasqyrat financiare për vlerën e inventarit më 31 dhjetor 2022 dhe 2021.

**3. Në shënimin 11**, në pasqyrën e pozicionit financiar më 31 Dhjetor 2022, paraqiten "Llogari të arkëtueshme tregtare", në vlerën 12,210,135 mijë Lek (2021: 13,174,589 mijë Lek). Si pjesë e procedurave të auditimit ne dërguam konfirmime direkte në palët e treta për shumat e arkëtueshme dhe deri në datën e këtij raporti nuk morëm konfirmime direkte apo akte rakordimi prej tyre. Për këto shuma ne nuk kemi mundur të arrijmë një siguri të mjaftueshme dhe të arsyeshme për saktësinë e tyre, as nëpërmjet procedurave të letrave të konfirmimit dhe as nëpërmjet kryerjes së procedurave alternative. Nga procedurat analitike rezulton se pjesa dërrmuese e këtyre kërkesave të arkëtueshme janë mbi 5 vjet të vjetra dhe shumë nga palët e treta nuk janë aktive në biznes. Zhvlerësimi i njohur për zërin "Llogari të arkëtueshme tregtare" nuk është i mjaftueshëm, për matjen e tyre ashtu siç kërkohet në përputhje me SNRF 9 "Instrumentet Financiare".

Për rrjedhojë ne nuk jemi në gjendje të vlerësojmë efektet që mund të rezultojnë nga korrigjimet e mundshme të tyre, në pasqyrat financiare të mbyllura më 31 Dhjetor 2022 dhe 2021.

**4. Në shënimin 12**, në pasqyrën e pozicionit financiar më 31 Dhjetor 2022, paraqiten "Llogari të arkëtueshme të tjera" në vlerën 4,725,614 mijë Lek (2021: 4,276,594 mijë Lek). Në këtë vlerë përfshihen si vijon:

- "Të drejta ndaj kontraktorëve për kontrata hidrokarbure", në vlerën neto 4,011,783 mijë Lek më 31 Dhjetor 2022 (2021: 3,279,529 mijë Lek). Këto vlera përfaqësojnë sasinë e produktit që kontraktorët kanë detyrim të dorëzojnë, por që nuk është lëvruar fizikisht në depozitat e Albpetrolit. Detyrimi i kontraktorëve përcaktohet në sasi prodhimi dhe shoqëria duhet të zbatojë parashikimet e SNRF 9, "Instrumentet financiarë" për klasifikimin dhe matjen e këtyre të drejtave kontraktuale. Shoqëria zbaton një model matje të mbështetur mbi çmimin e tregut në datën e raportimit dhe këtë e zbaton vetëm për kërkesat e reja, ndërsa për kërkesat e vjetra nuk është zbatuar një matje e mëpasshme. Për më tepër, si pjesë e procedurave të auditimit ne dërguam letra direkte tek kontraktorët por nuk arritëm të marrim konfirmime për vlera që janë paraqitur nga shoqëria. Ne jemi vënë në dijeni se shoqëria ka mosmarrëveshje me disa nga kontraktorët dhe ka çështje në proces në arbitrazh ndërkombëtar, por nuk na u vu në dispozicion evidencë në lidhje me këto çështje.
- "Të drejta për hua të dhëna" me kontratë dhe sipas urdhrave të aksionarit për vlerën 371,656 mijë lekë, për shoqërinë e lidhur Albga sha, e lëvruar që prej periudhës 2017. Gjithashtu, përfshihen edhe *Kërkesa të tjera debitore* në vlerën neto 278,815 mijë lekë (2021: 457,310 mijë lekë), të cilat përfaqësojnë marrëdhënie të vjetra mbi 3 vjet me individë dhe palë të treta debitorë, si dhe të drejta të pakonfirmuara ndaj autoritetit tatimor. Sipas SNRF 9, vonesa e arkëtimit për më shumë se 12 muaj përbën një bazë të përshtatshme për përcaktimin nëse rreziku i kredisë është rritur në një instrument financiar.

Në rastet kur ka një përkeqësim të pritshëm të arkëtimit të instrumentit financiar, shoqëria duhet të njohë një provizion për humbje sipas parashikimeve në SNRF 9. Si rrjedhojë e problematikave të përmendura në këtë paragraf, ne nuk jemi në gjendje të vlerësojmë efektet që mund të rezultojnë nga korrigjimet e mundshme për paraqitjen e kërkesave të tjera të arkëtueshme, në datat 31 Dhjetor 2022 dhe 2021.

**5. Në shënimin 14**, në pasqyrën e pozicionit financiar më 31 Dhjetor 2022, paraqitet "Kapitali themeltar" i shoqërisë në vlerën 14,735,229 mijë Lek (2021: 14,735,229 mijë Lek). Aksioneri MIE ka marrë 3 vendime për ndryshimin e kapitalit të regjistruar: me shkresën Nr. 779, datë 03.02.2017 dhe urdhrin Nr. 34, datë 01.02.2017 ka urdhëruar zmadhimin e kapitalit për vlerën e asetëve të marra në vendburimet Gorisht-Kocul dhe Cakran-Mollaj, në shumën 615,490 mijë Lek; me vendimin Nr. 1180, datë 28.01.2019 aksioneri MIE ka marrë vendim për zvogëlimin e kapitalit për vlerën e pasurisë pjesë e NRFISH kaluar të tretëve, në shumën 92,731 mijë Lek; me shkresën Nr. 6428/4, datë 03.01.2018 aksioneri MIE ka marrë vendim për zvogëlimin e kapitalit për vlerën e pasurisë në Sheq i Madh Fier, kaluar të tretëve, në shumën 9,803 mijë Lek. Këto vendime nuk janë depozituar në QKB dhe nuk janë paraqitur në vlerën e kapitalit themeltar por në llogarinë Rezerva Statutore. Si rezultat, llogaria e kapitalit themeltar paraqitet më e vogël për vlerën 512,954 mijë Lek më 31 Dhjetor 2022 dhe 2021.

**6. Në shënimin 18**, në pasqyrën e pozicionit financiar më 31 Dhjetor 2022, paraqitet "Fitimet e mbartura" në vlerën (13,930,374) mijë Lek (2021: (11,730,096) mijë Lek). Shoqëria ka regjistruar në zërin "Llogari të pagueshme tregtare" detyrimin për kamatëvonesat e furnitorit "Furnizuesi i Shërbimit Universal" në vlerën 2,211,134 mijë Lek, duke e njohur si sistemime të periudhave të mëparshme në zërin "Fitime të Mbartura". Bazuar në SNK 8 "Politikat Kontabël, Ndryshimet në Vlerësimet Kontabël dhe Gabimet", shoqëria duhet të reflektojë efektet e gabimeve duke ri paraqitur pasqyrat financiare për periudhat paraardhëse.

**7. Në shënimin 21**, në pasqyrën e pozicionit financiar më 31 Dhjetor 2022, paraqiten "Detyrime të tjera afatgjata", në vlerën 240,099 mijë Lek (2021: 240,099 mijë Lek). Këto balanca shfaqen si kundërvlerë e AAM-ve, të cilat nuk disponohen më nga shoqëria apo janë jashtë përdorimit. Në këto rrethana shoqëria duhet të zbatojë kërkesat e SNK 16 duke njohur këto vlera në pakësim të "Aktiveve Afatgjata Materiale" dhe jo si "Detyrime". Për rrjedhojë "Aktivet Afatgjata Materiale" dhe "Detyrimet e tjera" janë të mbivlerësuara për 240,099 mijë Lek më 31 Dhjetor 2022 dhe 31 Dhjetor 2021.

**8. Në shënimin 23**, në pasqyrën e pozicionit financiar më 31 Dhjetor 2022, paraqiten "Llogari të pagueshme tregtare" me vlerën 11,732,047 mijë Lek (2021: 10,209,198 mijë Lek). Për këto shuma ne nuk kemi mundur të verifikojmë saktësinë dhe plotësinë e tyre, as nëpërmjet sigurimit të letrave të konfirmimit dhe as nëpërmjet kryerjes së procedurave alternative. Për rrjedhojë ne nuk jemi në gjendje të vlerësojmë ndonjë efekt që mund të rezultonte nga ndonjë korrigjim i mundshëm i tyre, në pasqyrat financiare të mbyllura më 31 Dhjetor 2022 dhe 2021.


#### **Çështje të tjera**

Pasqyrat financiare për vitin 2021 janë audituar nga një grup audituesish, të cilët kanë shprehur një opinion të kualifikuar për pasqyrat financiare të mbyllura më 31.12.2021 në lidhje me zërat: "Aktive Afatgjata Materiale"; "Inventarë"; "Llogari të arkëtueshme tregtare"; "Llogari të arkëtueshme të tjera"; "Llogari të pagueshme tregtare"; "Llogari të pagueshme të tjera" dhe "Kapitali themeltar".

#### **Informacione të tjera**

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe publikimin e informacioneve të tjera në përputhje me Ligjin 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare". Opinioni ynë mbi pasqyrat financiare nuk mbulon informacionet e tjera dhe ne nuk shprehim asnjë konkluzion që jep siguri në lidhje me shpalosjen e këtyre informacioneve.

Si pjesë e auditimit, është përgjegjësia jonë të lexojmë këto informacione të tjera, nëse na vihen në dispozicion dhe të vlerësojmë nëse, bazuar në informacionet e marra gjatë auditimit tonë, ato përmbajnë ndonjë mospërputhje materiale me pasqyrat financiare ose ndonjë gabim material të dukshëm. Nëse konkludojmë se



ekziston një gabim material i fakteve në informacione të tjera, duhet ta raportojmë atë fakt. Ne nuk kemi asgjë për të raportuar në këtë drejtim.

### **Çështjet Kryesore të Auditimit**

Çështjet kryesore të auditimit janë ato çështje që në gjykimin tonë profesional, kanë qenë më të rëndësishmet në auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale. Këto çështje janë adresuar në kontekstin e auditimit të pasqyrave financiare në tërësi dhe të formimit të opinionit tonë në lidhje me to, kështu që për këto çështje ne nuk japim një opinion të veçantë.

Me përjashtim të çështjes së trajtuar në Seksionin e Bazës për Opinionin me Rezervë, Ne kemi përcaktuar si çështje kryesore të auditimit për të komunikuar në raportin tonë për pasqyrat financiare të mbyllura më 31 Dhjetor 2022, në lidhje me mos implementimin e sistemeve të informatizuara të cilat kanë ndikim të madh në procesin e raportimit financiar.

### **Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare**

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejte të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qofte për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likuidojë Shoqërinë ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

### **Përgjegjësia e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare**

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomali të mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve dhe marrim evidencë auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontroleve të brendshme.
- Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm që ka të bëjë me auditimin me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinionimi mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.
- Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë, dhe bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e Shoqërisë për të vijuar veprimtarinë. Nëse ne arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesve në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e

raportit tonë. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Shoqëria të ndërpresë veprimtarinë.

- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshire informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet në lidhje me to në një mënyrë që arrin paraqitjen e drejtë.

Ne komunikojmë me drejtimin, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshire ndonjë mangësi të rëndësishëm në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

Tiranë, më 30 Qershor 2023

Audituesit ligjorë,

**SOKOL TOSKA**



**EDISON TROSHANI**



**ILIA ÇEÇE**



## PËRMBAJTJE

RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR.....	5
Pasqyra e pozicionit Financiar.....	10
Pasqyra e Performancës dhe e të ardhurave gjithë përfshirëse.....	11
Pasqyra e Ndryshimeve në Kapitalin Neto për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2022.....	12
Pasqyra e Flukseve të Mjeteve Monetare.....	13
1. Informacion i pergjithshem.....	14
2. Bazat e pergatitjes.....	15
2.1. Deklarata e pajtuesmerise.....	15
2.2. Baza e matjes.....	15
2.3. Parimi i vijimesise.....	15
2.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes.....	15
2.5. Vleresime dhe gjykime.....	15
3. Aplikimi i standardeve nderkombetare te raportimit financiar te reja dhe te rishikuara.....	15
3.1 Standardet dhe interpretimet efektive ne periudhen aktuale.....	16
3.2 Standardet dhe interpretimet te leshuara, por ende nuk jane adoptuar.....	16
4. Politikat me te rendesishme kontabel.....	16
4.1. Transaksionet ne monedhe te huaj.....	16
4.2. Instrumentat financiare.....	17
4.2.1 Njohja dhe çrregjistrimi.....	17
4.2.2 Klasifikimi dhe matja fillestare e aktiveve financiare.....	17
4.2.3 Matja e mepasshme e aktiveve financiare.....	18
4.2.4 Zhvleresimi i aktiveve financiare.....	18
4.2.5 Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre.....	19
4.2.6 Llogari te arketueshme.....	19
4.2.7 Llogari te pagueshme.....	19
4.2.8 Hua te marra dhe te dhena.....	19
4.3. Inventaret.....	20
4.4. Aktive afatgjata materiale.....	20
4.5. Aktive afatgjata jomateriale.....	21
4.6. Te ardhurat.....	22
4.6.1 Te ardhurat nga shitja e sherbimeve dhe produkteve.....	22
4.6.2 Te ardhurat nga Grantet.....	22
4.6.3 Te ardhurat e tjera te shfrytezimit.....	22
4.6.4 Te ardhurat dhe shpenzimet financiare.....	22
4.7. Grantet.....	23
4.8. Qirate.....	23

4.9.	Tatimi mbi fitimin .....	23
4.10.	Perfitimet e punonjesve .....	23
4.11.	Provizionet .....	24
4.12.	Transaksionet me pale te lidhura .....	24
4.13.	Aktivet dhe detyrimet e kushtezuara .....	24
4.14.	Krahasueshmeria e informacionit kontabel .....	24
5.	Gjykime dhe vleresime kritike te kontabilitetit .....	24
5.	Gjykime dhe vleresime kritike te kontabilitetit (vazhdim) .....	25
5.1.	Te ardhura nga kontratat hidrokarbure .....	25
5.2.	Grantet .....	25
5.3.	Provizionet .....	25
5.4.	Zhvleresimi i inventareve .....	25
5.5.	Zhvleresimi i llogarive te arketueshme .....	25
6.	Aktivet afatgjata materiale .....	26
7.	Aktive afatgjata jo materiale .....	27
8.	Aktive Biologjike .....	28
9.	Inventare .....	28
10.	Shpenzime te shtyra .....	28
11.	Llogari te arketueshme tregtare .....	29
12.	Llogari te arketueshme te tjera .....	29
13.	Mjete monetare ne arke e ne banke .....	30
14.	Kapitali .....	30
15.	Primet e lidhura me kapitalin .....	31
16.	Rezerva rivleresimi .....	31
17.	Rezervat e kapitalit .....	31
18.	Fitim/(Humbjet) e mbartura .....	32
19.	Hua bankare .....	32
20.	Provizione .....	34
21.	Detyrime te tjera .....	34
22.	Grante dhe te ardhura te shtyra .....	34
23.	Llogari te pagueshme tregtare afatshkurtra .....	35
24.	Llogari te pagueshme te tjera .....	35
25.	Te ardhura nga aktiviteti i shfrytezimit .....	35
26.	Puna e kryer nga njesia dhe qe kapitalizohet .....	36
27.	Te ardhura te tjera .....	36
28.	Lenda e pare dhe materiale te konsumueshme .....	36
29.	Ndryshimi ne inventarin e produkteve te gatshme dhe prodhimit ne proces .....	37



30.	Shpenzime personeli.....	37
31.	Zhvleresimi i aktiveve afatgjata materiale.....	37
32.	Shpenzime te tjera te shfrytezimit.....	38
33.	Te ardhura dhe shpenzime interesi dhe te ngjashme neto.....	39
34.	Tatimi mbi fitimin.....	39
35.	Te ardhura te tjera gjithpershirese per vitin.....	39
36.	Manaxhimi i riskut financiar.....	39
37.	Transaksionet me pale te lidhura.....	42
38.	Angazhime dhe pasiguri.....	43
39.	Ngjarje pas dates se raportimit financiar.....	43

**Pasqyra e pozicionit Financiar**

	Shënime	31 Dhjetor 2022	31 Dhjetor 2021
<b>AKTIVE</b>			
<b>Aktivët afatgjatë</b>			
Aktivët afatgjatë materiale	6	30,928,906	31,115,579
Aktivët afatgjatë jomateriale	7	53,930	67,669
<u>Aktive biologjike</u>	8	108	108
<b>Totali i aktiveve afatgjatë</b>		<b>30,982,944</b>	<b>31,183,356</b>
<b>Aktivët afatshkurtra</b>			
Inventare	9	2,642,095	2,937,812
Shpenzime të shtyra	10	3,504	2,944
Llogari të arketueshme tregtare	11	12,210,135	13,174,589
Llogari të arketueshme të tjera	12	4,725,614	4,276,594
Mjetet monetare dhe ekuivalente të tyre	13	1,476,592	547,025
<b>Totali i aktiveve afatshkurtra</b>		<b>21,057,940</b>	<b>20,938,964</b>
<b>Totali i aktiveve</b>		<b>52,040,884</b>	<b>52,122,320</b>
<b>KAPITALI DHE DETYRIMET</b>			
<b>KAPITALI</b>			
Kapitali themeltar	14	14,735,229	14,735,229
Prime të lidhura me kapitalin	15	8,214,405	8,214,405
Rezerva rivleresimi	16	24,303,133	24,303,133
Rezerva ligjore	17	538,769	538,769
Rezerva statutore	17	512,954	512,954
Rezerva të tjera	17	909,719	909,719
Fitime të mbartura	18	(13,930,374)	(11,730,096)
<u>Fitimi i ushtrimit</u>		16,191	10,857
<b>Totali i kapitalit</b>		<b>35,300,026</b>	<b>37,494,970</b>
<b>DETYRIMET</b>			
<b>Detyrime afatgjatë</b>			
Hua afatgjatë	19	34,250	43,046
Provizione afatgjatë	20	399,685	280,000
Detyrime të tjera	21	240,099	240,099
<u>Grante dhe të ardhura të shtyra</u>	22	61,714	62,510
<b>Totali i detyrimeve afatgjatë</b>		<b>735,748</b>	<b>625,655</b>
<b>Detyrime afatshkurtra</b>			
Pjesa afatshkurter e huase afatgjatë	19	71,786	172,310
Llogari të pagueshme tregtare	23	11,732,047	10,209,198
<u>Llogari të pagueshme të tjera</u>	24	4,024,041	3,620,187
<u>Arkëtime në avancë për porosi</u>	24	177,236	
<b>Totali i detyrimeve afatshkurtra</b>		<b>16,005,110</b>	<b>14,001,695</b>
<b>Totali i detyrimeve</b>		<b>16,740,858</b>	<b>14,627,350</b>
<b>Totali i kapitalit dhe detyrimeve</b>		<b>52,040,884</b>	<b>52,122,320</b>

Këto pasqyra financiare janë miratuar nga drejtimi i shoqërisë më 30 Qershor 2023 dhe janë nënshkruar për publikim në emër të tyre nga:

Arta BESHAJ  
DREJTOR I DREJTORISË SË FINANCËS

Eltar DEDA  
ADMINISTRATOR

Pasqyra e Pozicionit Financiar duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

**Pasqyra e Performancës dhe e të ardhurave gjithë përfshirëse**

<b>Te ardhura operative</b>	<b>Shënime</b>	<b>Viti i mbyllur me 31 dhjetor 2022</b>	<b>Viti i mbyllur me 31 dhjetor 2021</b>
Te ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	25	6,955,072	5,599,623
Puna e kryer nga njësia dhe qe kapitalizohet	26	33,134	26,722
Te ardhura te tjera	27	76,966	50,051
<b>Totali i te ardhurave operative</b>		<b>7,065,172</b>	<b>5,676,396</b>
<b>Shpenzime Operative</b>			
Lenda e pare dhe materiale te konsumueshme	28	(2,385,481)	(1,422,712)
Ndryshimi ne inventarin e produkteve te gatshme dhe prodhimit ne proces	29	1,415,027	(512,528)
Shpenzime personeli	30	(1,532,255)	(1,660,545)
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	6,7	(402,196)	(424,959)
Zhvlerësimi i aktiveve afatgjata materiale	31		
<u>Shpenzime te tjera te shfrytëzimit</u>	32	(3,676,690)	(1,520,422)
<b>Total shpenzime</b>		<b>(6,581,595)</b>	<b>(5,541,166)</b>
<b>Te ardhura/ Shpenzime financiare neto</b>			
Te ardhura nga interesi	33	6,155	4,692
Shpenzime interesi dhe te ngjashme	33	(3,661)	(4,476)
<b>Totali te ardhura/ Shpenzime financiare neto</b>		<b>2,494</b>	<b>216</b>
<b>Fitimi/humbja para tatimit</b>		<b>486,071</b>	<b>135,446</b>
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	34	(469,880)	(124,589)
<b>Fitimi/humbja e vitit</b>		<b>16,191</b>	<b>10,857</b>
<b>Te ardhura te tjera gjithëpërfshirëse për vitin</b>	35		
<b>Totali i te ardhurave te tjera gjithëpërfshirëse per vitin</b>			

Pasqyra e Performancës dhe e të ardhurave gjithë përfshirëse duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

**Pasqyra e Ndryshimeve në Kapitalin Neto për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2022**

	Kapitali i nënshkruar	Primi i lidhur me kapitalin	Rezerva Rivlerësimi	Rezerva Ligjore	Rezerva Statutore të tjera	Rezerva Pashpërndara	Fitimet e Fitim i vitit	Interesa Jo-Kontrollues	
								Fitim i vitit	Totali
<b>Pozicioni financiar më 1 janar 2021</b>	14,735,229	8,214,405	24,303,133	538,769	512,954	909,719	(10,156,928)	(1,576,288)	37,480,993
Te tjera transferime					3,120				3,120
Transferim në fitime të mbartura					(1,576,288)		1,576,288		-
Fitim humbje të periudhës							10,857		10,857
<b>Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2021</b>	14,735,229	8,214,405	24,303,133	538,769	512,954	909,719	(11,730,096)	10,857	37,494,970
Totali i të ardhura gjithëpërfshirëse për vitin:							-		-
Transferim në fitime të mbartura					10,857		(10,857)		-
Te tjera transferime					(2,211,135)				(2,211,135)
Fitim humbje të periudhës							16,191		16,191
<b>Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2022</b>	14,735,229	8,214,405	24,303,133	538,769	512,954	909,719	(13,930,374)	16,191	35,300,026

Pasqyra e Ndryshimeve në Kapitalin Neto duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

### Pasqyra e Flukseve të Mjeteve Monetare

PASQYRA E FLUKSEVE TE MJETEVE MONETARE	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021
<b>Flukset e parasë nga aktivitetet operative</b>			
<b>Fitimi para tatimit</b>		486,071	135,445
<i>Rregullime për shpenzimet jo-monetare:</i>			
Shpenzime konsumi dhe amortizimi		402,196	424,959
Shpenzime Interesi		3,661	4,476
<i>Rregullime për ndryshimet në kapitalin punues</i>			
Rënie/(ritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera		515,433	(288,990)
Rënie/(ritje) në inventarë		295,717	787,340
Rënie/(ritje) në shpenzimet e shtyra		(560)	(2,944)
Rënie/(ritje) në detyrimet e pagueshme		1,522,849	(160,154)
Rënie/(ritje) në detyrimet e pagueshme të tjera		581,090	4,398
Provizione		119,685	
Të ardhura të shtyra		(795)	(861)
Tatimi mbi fitimin i paguar gjatë vitit		(469,880)	(41,108)
<b>Mjetet monetare të gjeneruara nga/përdorur në aktivitetin e shfrytëzimit</b>		<b>3,455,467</b>	<b>862,561</b>
<b>Fluksi I Mjeteve Monetare nga/ (përdorur në) Aktivitetet investuese</b>			
Pagesa për Blerjen e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale		(201,780)	(105,571)
Arkitime nga shitja aktiveve afatgjata materiale			
<b>Mjete monetare të gjeneruara nga/përdorur në aktivitetin investues</b>		<b>(201,780)</b>	<b>(105,571)</b>
<b>Fluksi I Mjeteve Monetare nga/ (përdorur në) Aktivitetet financuese</b>			
Hua të paguara		(172,310)	(206,693)
Hua të arkëtuara		62,986	
Te tjera transferime ne llogarine e fitimit te pashperndare		(2,211,135)	
Interes I paguar		(3,661)	(4,476)
<b>Mjete monetare të gjeneruara nga/përdorur në aktiviteti financues</b>		<b>(2,324,120)</b>	<b>(211,169)</b>
<b>Rritje/(renie) neto ne mjete monetare dhe ekuivalente te mjeteve monetare</b>		<b>929,567</b>	<b>545,821</b>
Mjete monetare dhe ekuivalente te mjeteve monetare në fillim të periudhës		547,025	1,204
<b>Mjete monetare dhe ekuivalente te mjeteve monetarnë fund të periudhës</b>	<b>13</b>	<b>1,476,592</b>	<b>547,025</b>

Pasqyra e Flukseve të Mjeteve Monetare duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

## 1. Informacion i përgjithshëm

Shoqëria Albpetrol Sha(shoqëria) me NIPT J82916500U, është krijuar me vendim Nr.21158, datë 08.04.1999 të Gjykatës Tiranë, sipas regjistrimit tregtar, bazuar në ligjin Nr. 7638, datë 19 Nëntor 1992 "Mbi shoqëritë tregtare". Selia e shoqërisë është në adresën Patos, Fier.

Shoqëria ka për objekt të veprimtarisë Kryerjen e Operacioneve Hidrokarbure në përputhje me Ligjin Nr. 7746, datë 28.08.1993 për Kërkimin Zhvillimin, Prodhimin, Trajtimin, Transportin, Magazinimin dhe Shitjen e naftës Brut, Gazit dhe Rërave Bituminoze brenda dhe jashtë Republikës së Shqipërisë si dhe çdo operacion tjetër tregtar apo shërbime që i shërbejnë aktivitetit të shoqërisë. Shoqëria brenda hapsirave të parashikuara nga legjilacioni në fuqi, do të kryejë çdo operacion projektues – preventivues, tregtar dhe financiar, që lidhet drejtpërdrejt ose tërthorazi me objektin e saj . Kjo përfshin gjithashtu hapjen e veprimtarisë dhe krijimin e shoqërive të tjera brenda dhe jashtë vendit si dhe çdo aktivitet tjetër të mundshëm e të ligjshëm në përputhje me interesat e saj. Realizimi i objektit të veprimtarisë të shoqërisë do të bëhet nëpërmjet shfrytëzimit dhe zhvillimit të zonave ekzistuese naftëmbajtëse dhe ato gazmbajtëse të vendit, kërkimeve të reja dhe zhvillimit të blloqeve në administrim si dhe shfrytëzim të rërave bituminoze. Praktika atributet e ish-APC-së Tiranë, që kanë të bëjnë me kërkim – prodhimin e hidrokarbureve, i kalojnë shoqërisë Alpetrol sha duke filluar nga data 01.04.2003. Furnizimin me energji elektrike të klientëve të kualifikuar. Tregtimin e energjisë elektrike. Shpërndarja e gazit natyror. Leje mjedisore për veprimtari me diktim në mjedis për vendburimet e naftës në zonat Kucovë, Patos-Marinëz ( Drizë +Goran), Ballsh Hekal, Amonic Gorisht, për vendburimet e gazit në zonën Divjak – Lushnjë, Frakull-Fier, Povelc Fier, Finiq – Sarandë, rrjeti i transmetimit të produkteve të naftës dhe të gazit., vendburimi i rërës bituminoze Kasnic-Fier, Uzina Mekanike Kucovë dhe Uzina Mekanike Patos.

Kapitali i nënshkruar i saj është 14,735,229,000 lekë, i ndarë në 14,735,229 aksione me vlerë nominale 1,000 lekë secili. Kapitali i paguar është regjistruar në Lekë.

Aksionet e Shoqërisë ALBPETROL Sha janë nën pronësinë e Republikës së Shqipërisë të përfaqësuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.

### Organet Drejtuese te Shoqërisë janë si më poshtë:

- Këshilli Mbikqyrës
- Administratori i Shoqërisë

Këshilli Mbikqyrës i ALBPETROL sha në datën 31.12.2022 përbëhet nga:

1.	z. Ilia	GJERMANI	Kryetar
2.	znj. Evis	MAMAJ	Anëtar
3.	z. Ardi	VELIU	Anëtar
4.	z. Stefanaq	KOCOLLARI	Anëtar
5.	z. Ermal	NUFI	Anëtar
6.	znj. Florenca	KORBI	Anëtar

Administratori i shoqërisë është Z. Eltar Deda.

Me vendim Nr. 2836/1, datë 01.04.2022, të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionerit, është miratuar Vendimi Nr. 5 datë 01.04.2022 i Këshillit Mbikqyrës të shoqërisë Albpetrol sha, për lirimin nga detyra e administratorit Z. Florjan Muçaj dhe me Vendim Nr.2835/1, datë 01.04.2022 të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionerit, është miratuar Vendimi Nr.6 i Këshillit Mbikqyrës për emërimin e Zj. Alketa Hila në detyrën e administratorit të shoqërisë. Me vendim Nr. 3628/1, datë 04.05.2022 të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionerit, është miratuar Vendimi Nr.10, datë 04.05.2022 i Këshillit Mbikqyrës të shoqërisë Albpetrol sha për lirimin nga detyra Zj. Alketa Hila dhe me Vendim Nr 3629/1, datë 04.05.2022, është miratuar Vendimi Nr.11, datë 04.05.2022, i Këshillit Mbikqyrës, për emërimin në detyrën e administratorit të shoqërisë

## **1. Informacion i përgjithshëm (vazhdim)**

Z. Klejdi Cenmurati. Me Vendimin Nr.7473/4- është miratuar Vendimi i Këshillit Mbikqyrës Nr.17 datë 10.10.2022 për emërimin në detyrë të Z.Eltar Deda.

Veprimtaria e perditshme e shoqërisë drejtohet nga Administratori, të cilit, i perkasin të gjitha kompetencat për drejtimin ekzekutiv dhe përfaqëson shoqërinë në marrëdhëniet me të tretet.

Numri i punonjësve më 31 dhjetor 2022 është 1.685 punonjës (2021: 1.727 punonjës).

Shoqëria aktualisht e ushtron aktivitetin e saj nëpërmjet 11 Njësive Operative ose qendra, të cilat përgatitin secila Pasqyra Financiare me vetë dhe nxjerrin rezultat të veçantë. Në drejtori, shoqëria përgatit Pasqyra Financiare përbledhese të bilanceve kontabel të njësive të saj. Kontabiliteti në Qendër është i informatizuar, ndërsa në njësitë vartëse mbahet në mënyrë të përzier, manuale dhe të informatizuar.

## **2. Bazat e përgatitjes**

### **2.1. Deklarata e pajtueshmërisë**

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Nderkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

### **2.2. Baza e matjes**

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Nderkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) të leshuara nga Bordi i Standardeve Nderkombëtare të Kontabilitetit ("BSNK") dhe interpretimet e nxjerra nga Komiteti për Interpretimet Nderkombëtare të Raportimit Financiar ("KIRFN") të BSNK-se.

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e kostos historike, përveç aktiveve afatgjata materiale të cilat maten me vlerën e rivlerësuar.

### **2.3. Parimi i vijimesisë**

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e parimit të vijimesisë, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

### **2.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes**

Keto pasqyra financiare janë paraqitur në Lek Shqiptar ("Lek"), e cila është monedha funksionale e Shoqërisë. Shumat janë paraqitur në "000" Leke përveç rasteve ku citohet ndryshe.

### **2.5. Vlerësime dhe gjykime**

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve të detyrimeve të kushtezuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabel.

Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar në mënyrë të detajuar në shënimet e këtyre pasqyrave financiare.

## **3. Aplikimi i standardeve nderkombëtare të raportimit financiar të reja dhe të rishikuara**

Politikat e adoptuara të kontabilitetit janë në përputhje me ato të vitit të kaluar financiar.

Ndryshimet që rrjedhin nga përmirësimet në SNRF nuk kanë ndonjë ndikim në politikat kontabel, pozicionin financiar apo në ecurinë e Shoqërisë.

Një numër standardesh të reja, ndryshime në standarde dhe interpretime nuk janë ende efektive për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022, dhe nuk janë aplikuar me heret në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare.

### **3.1 Standardet dhe interpretimet efektive ne periudhen aktuale**

Standardet e amenduara me poshte jane bere efektive per kompanine në 01 Janar 2022, por nuk jane zbatuar nga shoqeria:

Konçensione te lidhura me qirate ne kushtet e COVID-19 pertej 30 qershor 2021 (Ndryshime ne SNRF 16- Efektive nga 01 Janar 2021). Reforma e Normes se Interesit Krahasuese (Ndryshimet ne SNRF 9, SNK 39 dhe SNRF 7) Faza 2.

- Aktive afatgjate materiale: Te ardhurat perpara perdorimit te synuar (Ndryshimet ne SNK 16) - Ne fuqi nga 1 janari 2022

- Permiresimet Vjetore te Standardeve SNRF 2018-2020 (Ndryshimet ne SNRF 1, SNRF 9, SNRF 16 dhe SNK 41) - Ne fuqi nga 1 janari 2022

- Referencat ne Kuadrin Konceptual (Ndryshimet ne SNRF 3). Ne fuqi nga 1 janari 2022

### **3.2 Standardet dhe interpretimet te leshuara, por ende nuk jane adoptuar**

Bordi Nderkombetar i Standardeve te Kontabilitetit ka leshuar disa standarde dhe interpretime qe jane efektive me periudhat e ardhshme kontabel, zbatimi i të cilëve është opsional dhe kompania ka vendosur mos ti aplikojë paraprakisht. Kompania planifikon ti aplikojë keto standarde dhe interpretime kur ato te behen të detyrueshme.

Standardet dhe interpretimet e meposhtme jane leshuar, por nuk jane te detyrueshme per periudhen aktuale te raportimit te mbyllur me 31 dhjetor 2022:

- Kontratat me kushte - Kostoja e permbushjes se nje kontrate (Ndryshimet ne SNK 37) - Ne fuqi nga 1 janari 2022

- Dhenia e shenimeve shpjeguese te politikave kontabel (Ndryshimet ne SNK 1 dhe Deklarata e Praktikës IFRS 2) - Ne fuqi nga 1 janari 2023

- Perkufizimi i Vleresimeve Kontabel (Ndryshimet ne SNK 8) - Ne fuqi nga 1 janari 2023

- Tatimi i shtyre ne lidhje me aktivet dhe detyrimet qe rrjedhin nga nje transaksion i vetem (Ndryshimet ne SNK 12) - Ne fuqi nga 1 janari 2023

- SNRF 17 - Kontratat e Sigurimeve - Ne fuqi me 1 janar 2023.

## **4. Politikat me te rendesishme kontabel**

Politikat kontabel te meposhtme jane aplikuar ne menyre konsistente ne te gjitha periudhat e paraqitura ne pasqyrat financiare.

### **4.1. Transaksionet ne monedhe te huaj**

Transaksionet ne monedhe te huaj kembehen ne monedhen funksionale me kursin e kembimit ne daten e transaksionit. Aktivet dhe detyrimet monetare ne monedhe te huaj ne daten e raportimit kembehen ne monedhe funksionale me kursin e kembimit te asaj date. Fitimi ose humbja nga kurset e kembimit per zerat monetare eshte diferenca midis kosos se amortizuar ne monedhe funksionale ne fillim te vitit dhe kosos se amortizuar ne monedhe te huaj te kembjera me kursin e kembimit ne fund te vitit.



#### 4. Politikat me te rendesishme kontabel (vazhdim)

##### 4.1. Transaksionet ne monedhe te huaj (vazhdim)

Aktivitet dhe detyrimet jo-monetare te nominuara ne monedhe te huaj te cilat maten me vlere te drejte kembehen ne monedhen funksionale me kursin e kembimit te dates ne te cilen eshte percaktuar vlera e drejte. Zerat jo-monetare ne monedhe te huaj te cilat maten me kosto historike kembehen me kursin e kembimit ne daten e transaksionit.

Kurset e kembimit zyrtare bankare te zbatuara sipas Bankes se Shqiperise (Leke kundrejt njesise se monedhes se huaj) per monedhat kryesore me 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021 ishin si me poshte:

	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
EUR/Lek	114.23	120.76
USD/ Lek	107.05	106.54

##### 4.2. Instrumentat financiare

###### 4.2.1 Njohja dhe çrregjistrimi

Aktivitet dhe detyrimet financiare njihen kur Shoqeria behet pale e dispozitive kontraktuale te instrumentit financiar.

Aktivitet financiare çregjistrohen kur skadojne te drejtat kontraktuale te flukseve te mjeteve monetare nga aktivi financiar, ose kur aktivitet financiare transferohen dhe ne thelb te gjitha rreziqet dhe perfitimet transferohen. Blerjet dhe shitjet normale te aktiveve financiare kontabilizohen ne daten e transaksionit, qe eshte data ne te cilen shoqeria angazhohet te bleje apo te shese aktivin.

Nje detyrim financiar çregjistrohet kur shuhet, shkarkohet, anulohet ose skadon.

###### 4.2.2 Klasifikimi dhe matja fillestare e aktiveve financiare

Pervec atyre te arketueshme tregtare qe nuk permbajne nje perberes te konsiderueshem financimi dhe maten me çmimin e transaksionit ne perputhje me SNRF 15, te gjitha aktivitet financiare fillimisht maten me vleren e drejte te rregulluar per koston e transaksionit (aty ku eshte e aplikueshme).

Aktivitet financiare, te ndryshme nga ato te percaktuara dhe efektive si instrumenta mbrojtjes, klasifikohen ne kategorite e meposhtme:

- Me kosto te amortizuar (AC)
- Me vlere te drejte nepermjet fitimit ose humbjes (FVTPL)
- Me vlere te drejte nepermjet te ardhurave te tjera gjithepershires (FVOCI). Shoqeria aktualisht ka vetem aktive financiare te klasifikuara me kosto te amortizuar Klasifikimi percaktohet nga:
  - modeli i biznesit i njesise ekonomike per menaxhimin e aktivitet financiar
  - karakteristikat e flukseve monetare kontraktuale te aktivitet financiar.

Te ardhurat dhe shpenzimet qe lidhen me aktivitet financiare qe njihen ne fitim ose humbje paraqiten brenda shpenzimeve financiare, te ardhurave financiare ose zerave te tjere financiare, me perjashtim te shpenzimeve zhvleresimit te te arketueshmet tregtare te cilat perfshihen brenda shpenzimeve te tjera.

#### 4. Politikat me të rëndësishme kontabel (vazhdim)

##### 4.2 Instrumentat financiare (vazhdim)

##### 4.2.3 Matja e mëposhtme e aktiveve financiare

Aktivitetet financiare maten me koston e amortizuar nëse plotësojnë kushtet e mëposhtme (dhe nuk janë paracaktuara si FVTPL):

- ato mbahen në kuadër të një modeli biznesi, qëllimi i të cilit është mbajtja e mjeteve financiare dhe mbledhja e flukseve monetare kontraktuale
- kushtet kontraktuale të aktiveve financiare krijojnë flukse të mjeteve monetare që janë vetëm pagesa e principalit dhe interesit për shumën kryesore të papaguar

Pas njohjes fillestare, këto maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre, llogarite e arketueshme tregtare dhe llogarite e arketueshme të tjera, që me parë ishin klasifikuar si të mbajtura deri në maturim sipas SNK 39, bëjnë pjesë në këto kategori të instrumenteve financiare.

##### 4.2.4 Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Kërkesat për zhvlerësim të SNRF 9 përdorin me shumë informacione të ardhshme për të njohur humbjet e pritshme të kreditit- 'modelin e humbjeve të pritshme të kreditit (ECL)'. Kjo zëvendëson SNK 39 'modelin e humbjeve të ndodhura'. Instrumentet financiare në kuadër të kërkesave të reja përfshinin kredite dhe aktivet e tjera financiare të borxhit të matura me koston e amortizuar, llogarite e arketueshme, aktivet financiare të matura me vlerë të drejte përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, aktivet e kontraktuara të njohura dhe të matur sipas SNRF 15 dhe angazhimeve të huase dhe disa kontratave të garancise financiare (për emetuesin) që nuk maten me vlerën e drejte nepërmjet fitimit ose humbjes.

Njohja e humbjeve të kreditit nuk varet me prej identifikimit të një ngjarje individuale të humbjes së kredise mbi baze individuale. Në vend të kësaj, Shoqëria konsideron një game me të gjere informacioni gjatë vlerësimit të rrezikut të kredise dhe matjen e humbjeve të pritshme të kreditit, duke përfshirë ngjarjet e kaluara, kushtet aktuale, parashikimet e arsyeshme dhe të mbeshtetura që ndikojnë në arketueshmerinë e pritshme të flukseve monetare të ardhshme të instrumentit.

Në zbatimin e kësaj qasjeje të ardhshme, behet një dailim midis:

- instrumentet financiare që nuk janë perkeqesuar dukshëm në cilësinë e kredise që nga njohja fillestare ose që kanë rrezik të ulët të kredise ('Faza 1') dhe
- instrumentet financiare që janë perkeqesuar dukshëm në cilësinë e kredise që nga njohja fillestare dhe rreziku i kredise i të cilit nuk është i ulët ('Faza 2').

'Faza 3' do të mbulonte aktivet financiare që kanë tregues objektive të zhvlerësimit në datën e raportimit.

Humbjet e pritshme të kreditit '12 - mujore' njihen për kategorinë e parë, ndërsa 'humbjet e pritshme të kreditit përgjate jetes së instrumentit' njihen për kategorinë e dytë.

Matja e humbjeve të pritshme të kredise përcaktohet nga një vlerësim i ponderuar me probabilitetin e humbjeve të kredise gjatë jetes së pritshme të instrumentit financiar.

##### i) Zhvlerësimi i mëparshëm i aktiveve financiare sipas SNK 39

Në vitin paraprak, zhvlerësimi i aktiveve financiare është bazuar në modelin e humbjeve të ndodhura. Aktivitetet financiare individualisht të rëndësishme testoheshin për zhvlerësim kur kishin tregues për rënie në vlerë. Aktivitetet financiare, të cilat nuk ishin individualisht të rëndësishme rishikoheshin për zhvlerësim në grupe të përcaktuara në baze të karakteristikave të rrezikut të kreditit të përbashkët. Shoqëria kishte identifikuar dhe njohur zhvlerësim për aktivet financiare deri më 31 dhjetor 2022.

#### **4. Politikat me të rëndësishme kontabel (vazhdim)**

##### **4.2 Instrumentat financiare (vazhdim)**

###### **4.2.4 Zhvleresimi i aktiveve financiare (vazhdim)**

###### **ii) Klasifikimi dhe matja e detyrimeve financiare**

Duke qene se kontabilizimi i detyrimeve financiare mbetet kryesisht i njejte sipas SNRF 9 krahasuar me SNK 39, detyrimet financiare te Shoqerise nuk jane ndikuar nga adoptimi i SNRF 9.

Detyrimet financiare fillimisht maten me vleren e drejte dhe, kur eshte e aplikueshme, pershtaten per kostot e transaksionit, pervec nese Shoqeria ka percaktuar nje detyrim financiar me vlere te drejte nepermjet fitimit ose humbjes.

Me pas, detyrimet financiare maten me koston e amortizuar duke perdorur metoden e interesit efektiv, pervec derivativave dhe detyrimeve financiare te percaktuara ne FVTPL, te cilat mbahen me pas me vleren e drejte me fitimet ose humbjet te njohura ne fitim ose humbje (pervec instrumenteve financiare derivative te cilat jane te percaktuara dhe efektive si instrumente mbrojtese).

Te gjitha pagesat lidhur me interesin dhe, nese eshte e zbatueshme, ndryshimet ne vleren e drejte te nje instrumenti qe raportohen ne fitim ose humbje perfshihen ne kostot financiare ose te ardhurat financiare.

###### **4.2.5 Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre**

Mjetet monetare perfshijne arken, llogarite rrjedhese dhe depozitat ne para me bankat. Per qellimin e pasqyres se fluksit te parase, mjetet monetare perfshijne depozita me afat me nje maturim prej tre muajsh ose me pak qe nga data e fillimit.

###### **4.2.6 Llogari te arketueshme**

Llogarite e arketueshme njihen fillimisht me vleren e drejte dhe me pas duke zbritur humbjen nga zhvleresimi. Provizioni per zhvleresimin e llogarive te arketueshme llogaritet kur ka te dhena se shoqeria nuk do te jete ne gjendje te mbledhe te gjitha detyrimet. Veshtiresite financiare te debitorit, mundesia qe debitori te falimentoje ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues qe llogarite e arketueshme te zhvleresohen. Shuma e provizionit llogaritet si diference midis vleres se mbetur dhe vleres aktuale te flukseve te ardhshme te parashikuara te parase te skontuara me normen efektive te interesit.

###### **4.2.7 Llogari te pagueshme**

Llogarite e pagueshme paraqiten me vleren e tyre te drejte.

###### **4.2.8 Hua te marra dhe te dhena**

Huate e marra dhe te dhena njihen fillimisht dhe mbahen ne vazhdim me vleren e tregut, pa perfshire koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huate e marra dhe te dhena paraqiten me kosto te amortizuar duke njohur ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve çdo diference midis koston dhe vleres se pagueshme nominale pergjate periudhes se huamarrjes duke u bazuar ne interesin efektiv. Interesat e njohura ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve jane perllogaritur mbi bazen e interesit efektiv.

#### **4. Politikat me te rendesishme kontabel (vazhdim)**

##### **4.3. Inventaret**

Inventaret regjistrohen ne kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes perfshin te gjitha shpenzimet e kryera per ta sjelle inventarin ne vendin dhe kushtet ekzistuese.

Kostot e shnderrimit te inventareve perfshijne kostot e lidhura drejtperdrejte me njesite e prodhimit, siç eshte puna e drejtperdrejte. Ato perfshijne edhe nje shperndarje sistematike te shpenzimeve te pergjithshme te prodhimit fikse dhe variabel te cilat kryhen gjate shnderrimit te materialeve ne produkte te gatshme. Shpenzimet e pergjithshme te prodhimit fikse jane ato kosto jo te drejtperdrejte te prodhimit te cilat mbeten relativisht te pandryshueshme pavaresisht vellimit te prodhimit, si per shembull, amortizimi dhe mirembajtja e ndertesave dhe pajisjeve te fabrikes dhe kostot e drejtimit ete administrimit te fabrikes.

Shpenzimet e pergjithshme te prodhimit variabel jane ato kosto jo te drejtperdrejte te prodhimit te cilat ndryshojne ne menyre te direkte, ose thuajse te direkte, me ndryshimin e vellimit te prodhimit, si per shembull, materialet indirekte dhe puna indirekte.

Lendet e para Prodhime ne proces Produkt i gatshem

Me koston e blerjes dhe inventari i imet kosto blerje minus konsumin e llogaritur. Me kosto ne baze te metodës se mesatares se ponderuar

Me kosto te planifikuar.

##### **4.4. Aktive afatgjata materiale**

###### **i) Njohja dhe matja**

Zerat e aktiveve afatgjata materiale, paraqiten me vleren e rivlersuar, ne perputhje me rivleresimin e kryera ne daten 1 janar 2020.

Bazuar ne raportin e rivleresimit te Aktiveve dhe testin e zhvleresimit te shoqerise, sipas skemes kontabel qe rrjedh nga procesi i rivleresimit, u kryen veprimet kontabel sipas tabelave permbledhese per çdo qender te shoqerise. Efektet financiare jane reflektuar ne llogarite financiare qe prek ky proces per ushtrimin e meparsheh ne vitin 2020.

Kostot qe kane te bejne me permiresimet e mepasshme i shtohen koston se AAM-se vetem nese ato permbushin kriteret e perkufizimit te AAM-ve dhe kriteret per njohjen e aktiveve ne pasqyren e pozicionit financiar. Kostot qe lidhen me mirembajtjet dhe riparimet e vazhdueshme njihen si shpenzime gjate vitit ushtrimor.

Kostot perfshijne shpenzime qe jane kryer drejtpersedrejte per blerjen e aktivitet. Kostot e aktiveve te ndertuara nga vete shoqeria, perfshijne koston e materialeve dhe te fuqise punetore, si dhe ndonje kosto tjeter qe lidhet direkt me venien e aktivitet ne kushte pune, si dhe kostot e çmontimit te zhvendosjes dhe te magazinimit te tyre ne vendndodhjen perkatese. Shpenzimet kapitale te aktiveve te bera gjate ndertimit kapitalizohen ne "Ndertim ne proçes" dhe transferohen ne kategorine perkatese te aktivitet kur perfundon ndertimi tij, nga kur aplikohet amortizimi perkates sipas kategorise.

Kur pjese te nje zeri te aktiveve afatgjata materiale kane jete te dobishme te ndryshme, ato kontabilizohen si zera te ndryshem (komponente kryesor) te aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitja e nje zeri te aktiveve afatgjata materiale vendosen duke krahasuar te ardhurat monetare nga shitja me vleren e mbartur te aktiveve afatgjata materiale, dhe njihen neto brenda zerit "te ardhura te tjera" ne pasqyren ete ardhurave dhe shpenzimeve. Kur aktivitet e rivleresuara shiten, sasite e perfshira ne rezerven se rivleresimit transferohen ne fitimin e mbajtur, ndersa mungesa e rivleresimit njihet ne pasqyren ete ardhurave dhe shpenzimit te periudhes.

**4. Politikat me te rendesishme kontabel (vazhdim)****4.4. Aktive afatgjata materiale (vazhdim)****ii) Kosto te metejshme**

Kostoja e zevendesimit te nje pjese te nje elementi te aktiveve afatgjata materiale njihet ne vleren e mbartur te elementit nese eshte e mundshme qe perfitime ekonomike ne te ardhmen qe i atribuohen atij elementi do te rrjedhin ne Shoqeri dhe kostoja e tij mund te matet me besueshmeri. Kostot e sherbimeve ditore te aktiveve afatgjata materiale njihen ne pasqyren permbledhese te te ardhurave ne momentin kur ndodhin.

**iii) Amortizimi**

Amortizimi njihet ne pasqyren e te ardhurave e shpenzimeve me baze lineare per lidhjet teknologjike, puset e naftes, tubacione e rezervuar, mbi bazen e jetes se dobishme te vleresuar te çdo pjese te nje zeri te aktiveve afatgjata materiale dhe me metoden zbritese per ndertesat, makinerite dhe pajisjet, mjetet e transportit, pajisjet e zyres dhe kompjuterike, dhe aktivet e tjera me nje norme amortizimi siç shpjegohet me poshte. Toka dhe punimet ne proces nuk amortizohen.

Norma e amortizimit vjetor eshte si me poshte:

	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
<b>Baze lineare</b>		
Lidhjet teknologjike, puset, tubacione	1.5%	1.5%
<b>Metoda zbritese</b>		
Makineri dhe pajisje	20%	20%
Pajisje informatike e te tjera	25%	25%
Ndertesa	5%	5%

**iv) Çregjistrimi**

Nje ze i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashte perdorimit, apo atehere kur nuk priten me perfitime ekonomike te ardhshme nga perdorimi apo nxjerrja e tij jashte perdorimit. Fitimet dhe humbjet ne rastin e nxjerrjes jashte perdorimit te aktiveve afatgjata materiale, percaktohen sipas shumes se tyre te mbetur dhe merren parasysht ne nxjerrjen e rezultatit operativ te vitit.

**4.5. Aktive afatgjata jomateriale****i) Njohja dhe matja**

Liçensat, te drejtat e perdorimit te cilat perftohen nga Shoqeria paraqiten me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga zhvleresimi, nese ka.

**ii) Shpenzimet e mepasshme**

Shpenzimet e mepasshme kapitalizohen vetem ne rastin kur shtojne perfitimet e ardhshme ekonomike per aktivin specifik me te cilat ata lidhen. Te gjitha shpenzimet njihen si fitim/humbje kur ndodhin.

**iii) Amortizimi**

Amortizimi njihet ne pasqyren e te ardhurave gjithperfshirese duke perdorur metoden lineare mbi jetegjatesine e parashikuar te aktiveve jomateriale qe nga data qe jane te disponueshme per perdorim.

#### **4. Politikat me te rendesishme kontabel (vazhdim)**

##### **4.6. Te ardhurat**

Te ardhurat njihen atehere kur eshte e mundshme qe njesia ekonomike do te kete perfitime ekonomike ne te ardhmen dhe keto perfitime mund te maten me besueshmeri. Te ardhurat maten me vleren e drejte te arketuar ose te arketueshme qe merr parasysh shumen e çfaredo zbritje tregtare, zbritjet per shlyerje te menjehershme dhe zbritjet e bera per sasi (vellim) te blere.

##### **4.6.1 Te ardhurat nga shitja e sherbimeve dhe produkteve**

Te ardhurat nga shitja e naftes dhe gazit jane matur me vleren e drejte te pagesave te arketuara ose te arketueshme, pakesuar me tatimet dhe taksat mbi shitjet dhe mbi fitimin (akcizat, taksat e rruges, dhe te tjera te ngjashme). Te ardhurat nga shitja e mallrave jane matur me vleren e drejte te pagesave te arketuara ose per tu arketuar, pakesuar me tatimet dhe taksat mbi shitjet. Te ardhurat nga shitja jane vleresuar me vleren e drejte te kompesimit te marre, neto nga kthimet, uljet tregtare, uljet mbi volumet dhe rabatat. E ardhura eshte njohur kur rreziqet dhe te drejtat mbi produktet i kalojne ne nje pjese te rendesishme bleresit, marrja e kompesimit eshte e mundshme, kostot e lidhura dhe kthimet e mundshme te mallrave mund te maten me besueshmeri dhe nuk ka me perfshirje te vazhdueshme te drejtimit te Shoqerise me keto produkte.

##### **4.6.2 Te ardhurat nga Grantet**

Qeveria e Shqiperise ose/dhe Organizma Nderkombetare ofrojne Grante shoqerise ne lidhje me realizimin e investimeve ne infrastrukturen e rrjeteve. Fillimisht Granti njihet si detyrim ne Pozicionin Financiar nderkaq qe shuma e Grantit, njihet ne te ardhurat me realizimin e investimit ose shpenzimeve per realizimin e tyre. Ne rastin kur ofrohen grante per mbulimin e shpenzimeve te njesise ato njihen nete ardhura, ne masen e shpenzimit te realizuar.

##### **4.6.3 Te ardhurat e tjera te shfrytezimit**

Te ardhurat e tjera te shfrytezimit paraqesin te ardhurat qe perfitoen jo rregullisht gjate rrjedhes normale te veprimtarise ekonomike duke perfshire, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjate materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivleresimet e aktiveve afatgjate te investuara dhe fitim/humbjet qe vijne nga ndryshimi i kursit te kembimit perveç diferencave te kembimit qe lidhen me veprimtarite financiare dhe investuese.

##### **4.6.4 Te ardhurat dhe shpenzimet financiare**

Te ardhurat financiare perfshijne te ardhura interesi nga llogarite bankare dhe fitime nga kursi i kembimit qe njihen ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve. Te ardhurat nga interesi njihen mbi bazen e te drejtave te konstatuara duke perdorur metoden e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare perfshijne shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i kembimit, ndryshimet ne vleren e drejte te aktiveve financiare te mbajtura me vlere te drejte nepermjet llogarise fitim/humbje dhe humbjet nga zhvleresimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen ne pasqyren ete ardhurave dhe shpenzimeve me metoden e interesit efektiv.

#### **4. Politikat me te rendesishme kontabel (vazhdim)**

##### **4.7. Grantet**

Grantet që lidhen me aktivet, përfshirë grantet jo monetare me vlerë të drejte, paraqiten në pasqyrën e pozicionit financiar duke e njohur grantin si të ardhur të shtyre, e cila njihet si e ardhur në Pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera të përgjithshme në mënyrë sistematike dhe proporcionale për gjatë jetës së dobishme të aktivit.

##### **4.8. Qirate**

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirase. Qirate financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën me të ulët të vlerës së drejte të aktivitetit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirase në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirase me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve.

Shpenzimet e lindura nga qirate operative njihen në pasqyrën e të ardhurave në bazë të metodës lineare sipas kohezgjatjes së qirase.

##### **4.9. Tatimi mbi fitimin**

Tatim fitimi i vitit përbehet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyre. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zera që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritshëm për t'u paguar mbi fitimin e tatueshëm të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdo lloj rregullimi kontabel të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2022 është 15% (2021: 15%).

Tatimi i shtyre llogaritet duke përdorur metodën e bilancit kontabel, duke sjellë diferencën të perkohshme midis vlerës kontabel të aktiveve dhe pasiveve për raportin financiar dhe vlerës kontabel për qëllime tatimi. Diferencat e perkohshme nuk parashikohen për njohjen fillestare të aktiveve dhe pasive që nuk kanë asnjë ndikim mbi kontabilitetin apo fitimin e tatueshëm. Shuma e tatimit të shtyre bazohet në mënyrën e pritshme të realizimit apo shlyerjes së shumës së akumuluar të aktiveve dhe pasiveve, duke përdorur normat tatimore në fuqi në datën e bilancit.

Një aktiv i detyrimit të shtyre njihet vetëm nëse ka një ngjarje që fitime të ardhshme të tatueshme do të jenë në dispozicion, e ndaj të cilave aktiviteti mund të përdoret. Aktiviteti i tatimit të shtyre reduktohet deri në shkallën ku nuk është më e mundur që të realizohet përfitimi përkatës nga tatimi.

##### **4.10. Përfitimet e punonjësve**

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar.

#### **4. Politikat me te rendesishme kontabel (vazhdim)**

##### **4.11. Provizionet**

Provizionet njihen kur Shoqëria ka një detyrim aktual (ligjor ose të terthorte) si rezultat i një ngjarje nete kaluarë dhe ka mundësi që do të nevojitet një fluks burimesh që përfshin përfitimet ekonomike për të përmbushur detyrimin dhe në këtë mënyrë mund të bëhet një përlogaritje e besueshme e shumës së detyrimit. Në rast se efekti është material, provizionet janë përcaktuar duke skontuar flukset e pritshme të parase me normën e uljes para tatimeve, e cila reflekton vlerën kohore të parase në kushtet aktuale të tregut dhe, aty ku është e pershtatshme, normën e riskut të pasiveve specifike. Provizionet rishikohen në çdo datë bilanci dhe nëse nuk ka mundësi për nevojën e një fluksi burimesh që përfshin përfitimet ekonomike për shlyerjen e detyrimit, provizionet kthehen. Provizionet përdoren vetëm për qelimin që janë njohur fillimisht. Ato nuk njihen për humbjet e ardhshme operative.

##### **4.12. Transaksionet me pale të lidhura**

Palet e lidhura përcaktohen kur një pale kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si pale të lidhura.

##### **4.13. Aktivët dhe detyrimet e kushtezuara**

Detyrimet e kushtezuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e lartë. Një aktiv i kushtezuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtezuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm shumës së humbjes.

##### **4.14. Krahasueshmëria e informacionit kontabel**

Kur është e nevojshme, shifrat krahasuese axhustohen (rregullohen) konform me ndryshimet në paraqitje në periudhën aktuale raportuese. Riklasifikimet kryhen për të paraqitur me mirë natyrën e biznesit të Shoqërisë. Ato aplikohen retrospektivisht.

#### **5. Gjykime dhe vlerësime kritike të kontabilitetit**

Shoqëria kryen supozime dhe bën vlerësime të cilat kanë ndikim në shumën e raportuar të aktiveve dhe detyrimeve brenda vitit të ardhshëm financiar.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktore të tjera duke përfshirë pritshmeritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e eksperteve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabel që rezultojnë sipas perkufizimit, jo gjithmone do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë rrisht rëndësishëm për të shkaktuar korigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë.



## **5. Gjykime dhe vleresime kritike te kontabilitetit (vazhdim)**

### **5.1. Te ardhura nga kontratat hidrokarbure**

Shoqeria njej te ardhura nga kontrata hidorkarbura, sipas te cilave shoqeria perfiton produkte hidrokarbure me metoden e ndarjes se prodhimit. Ne kete proces behen gjykime dhe vleresime te mbeshtetura ne prodhimin konkret dhe ne parashikimit kontraktuale. Drejtimi mendon qe perlllogaritja e ketyre te ardhurave paraqet ne menyre te besueshme detyrimet kontraktuale.

### **5.2. Grantet**

Nje numer i caktuar grantesh jane perfshire ne librat, te perfituara nga transaksione te ndryshme me donator te ndryshem. Drejtimi analizoi destinacionin dhe dokumentacionin e ketyre granteve. Nje shume e caktuar grantesh kane qene dhuruar si kontribut ne materiale dhe aktive. Grantet njihen site ardhura per pjesen e amortizimit te aktiveve per te cilat jane perftuar.

### **5.3. Provizionet**

Provizionet ne pergjithesi kerkojne nje nivel te larte gjykimi, veçanerisht ne rastet e konflikteve gjyqesore. Shoqeria vlereson mundesine e krijimit te nje detyrimi aktual si rrjedhoje e nje ngjarje te shkuar, ne rast se mundesia e ndodhjes vleresohet te jete me shume se 50%, ne te tilla raste shoqeria provizionon vleren e detyrimit e cila mund te matet me besueshmeri. Per shkak te nivelit te larte te pasigurise, ne disa raste mund te ndodhe qe vleresimi mund te mos jete ne te njejten linje me rezultatin e çeshtjes. Manaxhimi vlereson ne fund te çdo periudhe ne rast se ka nevojë per krijimin e provizioneve.

### **5.4. Zhvleresimi i inventareve**

Shoqeria vlereson gjendjen e inventarit ne qarkullim te ulet dhe inventarin i cili ka humbur vleren e perdorimit per shkak te zhvillimeve teknologjike apo arsyeve te tjera, me synim per te percaktuar masen e zhvleresimit te inventarit, bazuar ne perdorimin e ardhshem te tij dhe ne llogaritjen e vleres neto te realizueshme. Ne rast se vlera neto e realizueshme e inventarit eshte me e ulet se vlera kontabel neto, ekziston nje tregues qe inventari eshte i zhvleresuar. Shoqeria perdor gjykimin e saj per te percaktuar masen e zhvleresimit.

### **5.5. Zhvleresimi i llogarive te arketueshme**

Zhvleresimi i llogarive te arketueshme bazohet ne humbjet e vleresuara te cilat rezultojne nga pamundesia e klienteve per te paguar detyrimet e tyre. Keto vleresime bazohen ne moshen e llogarive te arketueshme dhe eksperiencen e meparshme ne çregjistrimin, vleresimin e aftesise paguese te klienteve, si dhe ndryshimet e fundit dhe te pritshme te termave te pageses se klienteve. Manaxhimi vlereson ne fund te çdo periudhe ne rast se ka nevojë per zhvleresimin e llogarive te arketueshme.

## 6. Aktivet afatgjata materiale

Kosto	Toka	Ndërtesa	Makineri dhe Impiante	Pajisje informatike	Të tjera në Shfrytëzim	Totali
<b>Gjendja me 1 janar 2021</b>	<b>8,250,915</b>	<b>1,281,889</b>	<b>21,474,238</b>	<b>70,000</b>	<b>817,506</b>	<b>31,894,548</b>
Shtesa	1,121		50,756	100	75,568	127,545
Pakesime			-4,179			-4,179
Riklasifikime midis grupeve		-406	49,045	-1,142	-47,474	23
<b>Gjendja me 31 dhjetor 2021</b>	<b>8,252,036</b>	<b>1,281,483</b>	<b>21,569,861</b>	<b>68,958</b>	<b>845,600</b>	<b>32,017,938</b>
<b>Gjendja me 1 janar 2022</b>	<b>8,252,036</b>	<b>1,281,483</b>	<b>21,569,861</b>	<b>68,958</b>	<b>845,600</b>	<b>32,017,938</b>
Shtesa		15,170	133,262		53,599	202,031
Pakesime			-1,022		-169	-1,191
Riklasifikime midis grupeve		-12	45,377	-23,686	-21,680	0
<b>Gjendja me 31 dhjetor 2022</b>	<b>8,252,036</b>	<b>1,296,641</b>	<b>21,747,478</b>	<b>45,272</b>	<b>877,351</b>	<b>32,218,778</b>
<b>Amortizimi i akumuluar</b>						
<b>Gjendja me 01 Janar 2021</b>		<b>38,872</b>	<b>437,639</b>	<b>16,136</b>		<b>492,647</b>
Amortizimi i periudhes		36,867	365,415	8,138		410,420
Pakesime			-708			-708
Riklasifikime midis grupeve		460	-461	1		0
<b>Gjendja me 31 dhjetor 2021</b>		<b>76,198</b>	<b>801,885</b>	<b>24,275</b>		<b>902,358</b>
<b>Gjendja me 01 Janar 2022</b>		<b>76,198</b>	<b>801,885</b>	<b>24,275</b>		<b>902,358</b>
Amortizimi i periudhes		35,181	347,967	4,367	0	387,515
Pakesime						
Riklasifikime midis grupeve						
<b>Gjendja me 31 dhjetor 2022</b>	<b>0</b>	<b>111,379</b>	<b>1,149,851</b>	<b>28,642</b>		<b>1,289,873</b>
<i>Vlera neto kontabel</i>						
<b>Gjendja me 31 dhjetor 2021</b>	<b>8,252,036</b>	<b>1,205,285</b>	<b>20,767,976</b>	<b>44,683</b>	<b>845,599</b>	<b>31,115,579</b>
<b>Gjendja me 31 dhjetor 2022</b>	<b>8,252,036</b>	<b>1,185,262</b>	<b>20,597,627</b>	<b>16,630</b>	<b>877,351</b>	<b>30,928,906</b>

## 6. Aktivet afatgjata materiale (vazhdim)

Megjithatë, ne 31 dhjetor 2022 Albpetrol sha, nuk i ka te regjistruara te gjitha pronat ne Regjistrin e Pasurive te Paluajtshme. Shoqeria eshte duke vazhduar procesin per regjistrimin e pasurive te paluajtshme.

Te dhena mbi vleren historike te Aktiveve Afatgjata

Emërtimi	Vlera fillestare	Amortizim akumuluar	Vlera e mbetur
Toka	11,311,181,304	0	11,311,181,304
Ndërtesa	2,475,298,422	1,855,816,554	619,481,868
Pajisje zyre & informatike	133,601,690	115,943,502	17,658,188
Te tjera ne shfrytëzim	1,428,047,177	885,719,600	542,327,577
Makineri & Impiante	35,224,955,402	33,005,015,951	2,219,939,451
Aktive biologjike	120,833	0	120,833
<b>Totali AAM</b>	<b>50,573,204,827</b>	<b>35,862,495,607</b>	<b>14,710,709,220</b>
AAJM	154,600,932	154,599,990	942
<b>Totali Aktive Afatgjata</b>	<b>50,727,805,759</b>	<b>36,017,095,597</b>	<b>14,710,710,162</b>

## 7. Aktive afatgjata jo materiale

Aktive afatgjata jomateriale me 31 dhjetor 2022 dhe 2021 detajohen si me poshte:

### Me kosto

	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
<b>Gjendja me 1 janar 2021</b>	<b>96,932</b>	<b>154,600</b>
Pakesime nga sistemimi i amortizimit te akumuluar		(45,338)
Pakesime nga rivleresimi I AAM		(11,085)
<b>Gjendja me 31 dhjetor 2021</b>	<b>96,932</b>	<b>98,176</b>
Pakesime Shtesa	942	(1,221)
Pakesime nga rivleresimi i AAM		(23)
<b>Gjendja me 31 dhjetor 2022</b>	<b>97,874</b>	<b>96,932</b>
<b>Amortizimi</b>		
<b>Gjendja me 1 janar 2021</b>	<b>(14,723)</b>	<b>(45,338)</b>
Amortizimi i vitit	(14,540)	(14,723)
Pakesime nga rivleresimi i AAM		45,338
<b>Gjendja me 31 dhjetor 2021</b>	<b>(29,263)</b>	<b>(14,723)</b>
Amortizimi i vitit	(14,681)	(14,540)
Pakesime nga rivleresimi i AAM		
<b>Gjendja me 31 dhjetor 2022</b>	<b>(43,944)</b>	<b>(29,263)</b>
<b>Gjendja neto me 31 dhjetor 2021</b>	<b>67,669</b>	<b>83,453</b>
<b>Gjendja neto me 31 dhjetor 2022</b>	<b>53,930</b>	<b>67,669</b>

**8. Aktive Biologjike**

Aktivitet biologjike me 31 dhjetor 2022 në vlerën 108 mijë lekë (2021: 108 mijë lekë) përfaqësojnë aktivitet drufrutore të Qendres Mekanike Kuçove.

**9. Inventare**

Në këtë zë janë përfshirë materialet ndihmëse dhe lenda djegëse, balanca e se cilave me 31 dhjetor 2022 dhe 2021 paraqitet si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2022</u>	<u>31 dhjetor 2021</u>
1-Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme	333,349	292,784
<i>a - Lende e parë dhe materiale të konsumueshme</i>	442,098	430,271
<i>b- Zhvlerësimi i materialeve</i>	(108,749)	(137,487)
2- Prodhime në proces dhe gjysem produkte	28,553	31,007
3- Produkte të gatshme	1,294,398	945,802
4- Mallra	985,795	1,668,219
<i>a-Mallra</i>	1,700,759	1,668,219
<i>b-Zhvlerësimi i mallrave</i>	(714,964)	
<b>Totali</b>	<b><u>2,642,095</u></b>	<b><u>2,937,812</u></b>
<i>Levizjet në zhvlerësimin e inventarit:</i>		
Gjendja në 1 Janar	137,487	137,487
<i>Zhvlerësim mallrash për vitin</i>	686,226	
<b>Gjendja në 31 Dhjetor</b>	<b><u>823,713</u></b>	<b><u>137,487</u></b>

**10. Shpenzime të shtyra**

Shpenzimet e shtyra me 31 dhjetor 2022 dhe 2021 detajohen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2022</u>	<u>31 dhjetor 2021</u>
Parapagim SIGAL për siguracionin e mjeteve	3,504	2,944
<b>Gjendja me 31 dhjetor</b>	<b><u>3,504</u></b>	<b><u>2,944</u></b>

**11. Llogari te arketueshme tregtare**

Balanca e llogarive te arketueshme tregtare te shoqerise me 31 dhjetor 2022 dhe 2021 paraqitet si me poshte:

	<u>31 dhjetor 2022</u>	<u>31 dhjetor 2021</u>
<b>Llogari te arketueshme</b>	18,933,278	18,887,732
<i>Deri 1 vit</i>	1,608,459	1,675,260
<i>Mbi 1 vit</i>	17,324,819	17,212,472
Zhvleresimi kerkesave te arketueshme	(6,723,143)	(5,713,143)
<b>Totali</b>	<b>12,210,135</b>	<b>13,174,589</b>
 <i>Levizjet ne zhvleresimin e te drejtave per arketim:</i>		
	<u>31 dhjetor 2022</u>	<u>31 dhjetor 2021</u>
<b>Gjendja me 1 janar</b>	5,713,143	560,971
<i>Zhvleresimi per vitin</i>	1,010,000	5,152,172
<b>Gjendja me 31 dhjetor</b>	<b>6,723,143</b>	<b>5,713,143</b>

Ne kete pozicion perfshihen te drejta per arketim nga shoqeria ARMO sha per shumen 11,464,502 mije leke (2021: 11,464,502 mije leke). Shoqeria ARMO nuk zhvillon me aktivitete. Gjithashtu, shoqeria ka detyrime ndaj kesaj shoqerie ne shumen 6,312,329 mije leke (2021: 6,312,329 mije leke), shiko shenimin 23 te ketyre pasqyrave financiare. Te drejtat dhe detyrimet ndaj ARMO sha jane paraqitur ne vlera bruto dhe nuk jane kryer kompensime. Per kontraktorin Transatlantic Albania, ne vitin 2022 eshte krijuar provizion ne vleren neto te se drejtes per 1,010,000 mije leke.

**12. Llogari te arketueshme te tjera**

Llogarite e tjera te arketueshme me 31 dhjetor 2022 dhe 2021 detajohen si me poshte:

	<u>31 dhjetor 2022</u>	<u>31 dhjetor 2021</u>
Te drejta nga kontraktoret	4,741,783	3,679,529
Zhvleresim i kerkesave ndaj nenkontraktoreve	(730,000)	(400,000)
Hua te dhena	715,994	652,634
Zhvleresim i huave te dhena	(280,978)	(112,880)
Aktive(kerkesa) te tjera	1,476,054	1,440,565
<i>Deri 1 vit</i>	51,376	13,307
<i>Mbi 1 vit</i>	1,424,678	1,427,258
Zhvleresim i kerkesave te tjera	(1,197,239)	-983,254
<b>Totali</b>	<b>4,725,614</b>	<b>4,276,594</b>

**12. Llogari te arketueshme te tjera (vazhdim)***Levizjet ne zhvleresimin e te drejtave per arketim:*

	<u>31 dhjetor 2022</u>	<u>31 dhjetor 2021</u>
Gjendja me 1 janar	1,496,134	1,296,134
Provizione per kontraktoret HK	330 000	200,000
Provizione per huate e dhena	168,099	
Provizion per kerkesa te tjera	213,984	
<b>Gjendja me 31 dhjetor</b>	<b>2,208,217</b>	<b>1,496,134</b>

Ne total provizione per llogari te arketueshme te tjera paraqitet:

	<u>31 dhjetor 2022</u>
Provizione per kontraktoret HK	730 000
Provizione per huate e dhena	280,978
Provizion per kerkesa te tjera	1,197,239
<b>Gjendja me 31 dhjetor</b>	<b>2,208,217</b>

Ne aktive te tjera, shuma 4,741,783 mije leke, paraqet te drejtat e shoqerise, qe rrjedhin nga detyrimet kontraktuale te te treteve konform parashikimit te termave te kontratave hidrokarbure, te lidhura midis Shoqerise Albpetrol sha dhe kontraktoreve, qe duhet te ishin marre ne dorezim, por qe nuk jane levruar fizikisht ne depozitat e Shoqerise Albpetrol sha. Hua te dhena paraqet transferime fondesh te kryera nga Albpetrol sha, ne favor te kompanive te tjera publike nepermjet kontratave te huave.

**13. Mjete monetare ne arke e ne banke**

Balanca e mjeteve monetare me 31 dhjetor 2022 dhe 2021 detajohen si me poshte:

	<u>31 dhjetor 2022</u>	<u>31 dhjetor 2021</u>
Mjete monetare ne Banka	1,476,582	547,015
Mjete monetare ne Arka	9,728	9,395
<b>Totali</b>	<b>1,476,592</b>	<b>547,025</b>

**14. Kapitali**

Kapitali i shoqerise me 31 dhjetor 2022 eshte 14,735,229 mije leke {2021: 14,735,229 mije leke} i zoteruar 100% nga Ministria e Energjise dhe Industrise.

	<u>31 dhjetor 2022</u>	<u>31 dhjetor 2021</u>
Numri aksioneve	14,735,229	14,735,229
Vlera nominale (ne leke)	1,000	1,000
<b>Totali (ne mije leke)</b>	<b>14,735,229</b>	<b>14,735,229</b>

**15. Primet e lidhura me kapitalin**

Primet e lidhura me kapitalin me 31 dhjetor 2022 paraqiten ne vleren 8,214,405 leke (2021: 8,214,405 leke), kjo vlere perfaqeson koston historike te tokes per te cilin nuk disponohet nje dokument hipotekor dhe per kete arsye, ne momentin e themelimit te shoqerise, nuk jane perfshire ne kapitalin ligjor por jane paraqitur si prime.

Primi i lidhur me kapitalin me 31.12.2022, paraqitet:

	<u>31 dhjetor 2022</u>	<u>31 dhjetor 2021</u>
Gjendja me 1 janar	8,214,405	8,214,405
Ndyshim gjate vitit		
<b>Gjendja me 31 dhjetor</b>	<b>8,214,405</b>	<b>8,214,405</b>

**16. Rezerva rivleresimi**

Rezerva rivleresimi me 31 dhjetor 2022 ne vleren 24,303,133 mije leke (2021: 24,303,133 mije leke). Viti 2020 ishte viti i ndryshimit ne zvogelim i llogarise. Rezerva Rivleresimi paraqitet si me poshte:

	<u>31 dhjetor 2022</u>	<u>31 dhjetor 2021</u>
Gjendja me 1 janar	24,303,133	24,303,133
Ndyshim gjate vitit		
<b>Gjendja me 31 dhjetor</b>	<b>24,303,133</b>	<b>24,303,133</b>

**17. Rezervat e kapitalit**

Rezerva ligjore me 31 dhjetor 2022 paraqitet ne shumen 538,769 mije leke (2021: 538,769 mije leke).

	<u>31 dhjetor 2022</u>	<u>31 dhjetor 2021</u>
Gjendja me 1 janar	538,769	538,769
Ndyshim ne rezerve gjate vitit		
<b>Gjendja me 31 dhjetor</b>	<b>538,769</b>	<b>538,769</b>

Rezerva statutore me 31 dhjetor 2022 paraqitet ne shumen 512,954 mije leke (2021: 512,954 mije leke) si vijon:

	<u>31 dhjetor 2022</u>	<u>31 dhjetor 2021</u>
Gjendja me 1 janar	512,954	512,954
Ndyshim ne rezerve gjate vitit		
<b>Gjendja me 31 dhjetor</b>	<b>512,954</b>	<b>512,954</b>

Kapitalet e veta paraqiten ne shumen 14.735.229 mije leke (2021: 14.735.229 mije leke). Aksioneri MIE ka marre vendim per ndryshimin e kapitalit te regjistruar: me shkresen nr.779, date 03.02.2017, urdher nr. 34, date 01.02.2017 zmadhim te kapitalit per vleren e aseteteve te marra nga AKBN-ja per vendburimet Gorisht-Kocul dhe Cakran- Mollaj ne shumen 615.490 mije leke;

me vendimin nr. 1180, date 28.01.2019 aksioneri ka marre vendim per zvogelim te kapitalit te regjistruar te shoqerise ne vleren 92.731 mije leke me nr. 6428/4, date 03.01.2018 eshte marre vendim per zvogelimin e kapitalit te regjistruar te shoqerise per vleren e pasurise nr.44/5, volumi 14, fq 226 me emertese truall me siperfaqe 15.739 m2 ne Sheq i Madh Fier, ne shumen 9.803 mije leke.

Keto vendime nuk jane depozituar dhe reflektuar ne regjistrin tregtar te shoqerise te publikuar ne QKB, si rezultat llogaria e kapitalit te regjistruar nuk paraqet gjendjen reale.

Rezerva te tjera me 31 dhjetor 2022 paraqiten ne shumen 909,719 mije leke {2021: 909,719 mije leke}. Keto rezerva perfaqesojne fitime te pashperndara nga periudha te kaluara, te ngelura pa u destinuar nga aksionari.

	<u>31 dhjetor 2022</u>	<u>31 dhjetor 2021</u>
Gjendja me 1 janar	909,719	909,719
Ndyshim ne rezerve gjate vitit		
<b>Gjendja me 31 dhjetor</b>	<b>909,719</b>	<b>909,719</b>

#### 18. Fitim/(Humbjet) e mbartura

Fitim/(Humbjet) e mbartura me 31 dhjetor 2022 jane vleren (13,930,374) mije leke (2021: (11,730,096)mije leke), Pakesimi i fitimit te pashperndare me 31 dhjetor 2022 paraqitet si me poshte:

	<u>31 dhjetor 2022</u>	<u>31 dhjetor 2021</u>
Gjendja me 1 janar	(11,730,096)	(5,004,756)
Sistemime te periudhave te meparshme	(2,211,134)	(5,152,171)
Sistemim diference trualli, QSHGJ (UMPatos)nga rezultatet e inventarizimit.		1,120
Sistemim me llogari ne pritje per mungesat ne pajisjet nentokesore		1,999
Rezultati viti paraardhes	10,857	(1,576,288)
<b>Gjendja me 31 dhjetor</b>	<b>(13,930,374)</b>	<b>(11,730,096)</b>

#### 19. Hua bankare

Huate afatgjata me 31 dhjetor 2022 dhe 2021 paraqiten si me poshte:

	<u>31 dhjetor 2022</u>	<u>31 dhjetor 2021</u>
E pagueshme deri 1 vit	71,786	172,310
E pagueshme mbi 1 vit	34,250	43,046
<b>Totali</b>	<b>106,036</b>	<b>215,356</b>

Shoqeria ka dy hua te quajtura Kredia Italiane dhe Kredia Superiore. Japim informacione per secilen ne vijim.



**1- Kredia italiane**

Ndermjet Qeverise se Republikës se Shqipërisë dhe Institutit Qendror për Kreditin Afatmesëm SPA, është lidhur Marreveshja Financiare për Programin e Mbeshtetjes së Bilancit të Pagesave me vlerë 22 miliardë lireta (Projekti COMM 98-F.ROT/AID-98/001/00) konvertuar në euro, e administruar nga Banka Kombëtare Tregtare për AlbpëtroL sh.a. dhe ish Servcom sh.a. Kjo hua paraqitet në dy nga njesitë e AlbpëtroL në Qendrën e Furnizimit të Materialeve dhe në Qendrën e Shërbimeve Gjeofizike Patos (ish Servcom).

Paraqesim në vijim kredinë italiane të detajuar sipas maturimit.

	<u>31 dhjetor 2022</u>	<u>31 dhjetor 2021</u>
E pagueshme deri 1 vit	71,786	76,293
E pagueshme mbi 1 vit	34,250	43,046
<b>Totali</b>	<b>106,036</b>	<b>119,339</b>

E shprehur në monedhën Euro, detyrimi në total për kredinë italiane është 928.265 Euro, nga të cilat 568,465 Euro është detyrimi ndaj Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, për likuidimet që kjo Ministri ka kryer për shoqërinë AlbpëtroL sh.a. Në vijim ndarja e kredisë sipas destinacionit të shlyerjes e shprehur e përkthyer në Lekë.

	<u>31 dhjetor 2022</u>	<u>31 dhjetor 2021</u>
Banka Kombëtare Tregtare	41,100	50,691
Ministria Financave dhe Ekonomisë	64,936	68,648
<b>Totali</b>	<b>106,036</b>	<b>119,339</b>

**2- Kredia Superiore**

Ndermjet Shoqërisë AlbpëtroL sh.a dhe Bankës Amerikane të Investimeve, është lidhur kontratë kredie bankare me qëllim pagimin e pagave të punonjësve të shoqërisë, sipas skemës së garancisë së ofruar nga qeveria shqiptare si pasoje e paketës mbështetëse për subjektet e prekura nga masat e jashtëzakonshme të marra në kuadër të pandemisë Covid-19.

Garancia shtetërore është garancia e dhënë nga qeveria shqiptare sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr 277, datë 06.04.2020, ndryshuar me VKM nr 370, datë 06.05.2020, për pagat e subjekteve të prekura nga masat e ndërmarrura nga qeveria për menaxhimin e situatës së krijuar si pasoje e Covid -19 dhe për përfitimin e se çiles shoqëria ka nënshkruar Marreveshjen e Mirebesimit.

Paraqesim në vijim detaje mbi kredinë superiore.

	<u>31 dhjetor 2022</u>	<u>31 dhjetor 2021</u>
E pagueshme deri 1 vit (Kredi Superiore)	0	96,017
E pagueshme mbi 1 vit (Kredi Superiore)	0	0
<b>Totali</b>	<b>0</b>	<b>96,017</b>

## 20. Provizione

Provizionet me 31 dhjetor 2022 ne shumen 399,685 mije leke (2021: 280,000 mije leke) provizioneve per rreziqe te ndryshme. Ne vijim paraqesim levizjet per periudhen perfaqesojne vleren e provizioneve per rreziqe te ndryshme. Ne vijim paraqesim levizjet per periudhen:

	<u>31 dhjetor 2022</u>	<u>31 dhjetor 2021</u>
Gjendja me 1 janar	280,000	180,000
Krijim provizione për rreziqe gjyqësore	119,685	100,000
<b>Gjendja me 31 dhjetor</b>	<b>399,685</b>	<b>280,000</b>

Vlera prej 280.000 mije leke nga periudha te kaluara perfshin shumen prej 250,000 mije leke provizione per çeshtje gjyqësore ne proces si dhe shumen prej 30,000 mije leke, e cila trashegohet nga bashkimi me perthithje i Uzines Mekanike Patos dhe Transnafta Patos me Shoqerine Albpetrol sha. Ne vitin 2022, jane krijuar provizione per shpenzime gjyqësore ne vleren 119,685 mije leke.

## 21. Detyrime te tjera

Detyrime te tjera me 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021 paraqitet si me poshte:

	<u>31 dhjetor 2022</u>	<u>31 dhjetor 2021</u>
Kunderparti AAM pa perfshire ne kapital	140,753	140,753
Kunderparti per asete pa vlere perdorimi	337	337
Kunderparti per asetet e NJ.Z.I. ne privatizim	99,009	99,009
<b>Totali</b>	<b>240,099</b>	<b>240,099</b>

Shuma 140,753 mije leke paraqet fondin Kunderparti AAM per asetet e Nj.Z.I (ne privatizim),ne momentin e bashkimit te Albpetrol me Uzinat Mekanike. (Raporti i zmadhimit te kapitalit te Albpetrol sha qe vjen nga bashkimi me perthithje i shoqerise Albpetrol sha te Uzines Mekanike Patos dhe Uzines Mekanike te Naftes Kucove).

Shuma 337 mije leke paraqet fondin k/parti per asete pa vlere perdorimi te QMN Kucove (Uzina Mekanike Naftes Kucove), te trasheguar nga momenti i shkeputjes nga shoqeria Servcom sha.

Shuma 99,009 mije leke paraqet vleren e aktiveve ne Trasnafta Patos, qe nuk gjenerojne te ardhura. Mosperfshirja ne shumen e zmadhimit te kapitalit te vleres se ketyre aseteve eshte motivuar nga fakti se keto aktive nuk do ti sherbejne aktivitetit te ardhshem te kompanise. Baza ligjore e ketij veprimi eshte VKM nr. 784, dt.15/09/2006, pika 6 (raporti zmadhimit te kapitalit te Albpetrol sha qe vjen nga bashkimi me perthithje te shoqerive Albpetrol sha, Servcom sha Fier dhe Transnafta Patos).

## 22. Grante dhe te ardhura te shtyra

Grante dhe te ardhura te shtyra me 31 dhjetor 2022 ne vleren 61,714 mije leke (2021: 62,510 mije leke) paraqet grantet e perfituara nga shoqeria per aktive afatgjata materiale. Grantet jane njohur ne te ardhura ne menyre sistematike gjate periudhes kontabel. Pakësimi neto i tyre per

vitin 2022 ne shumen 795 mijë leke (2021: 861 mijë leke) pasqyrohet ne Pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve siç detajohet ne shenimin "Te ardhura te tjera".

### 23. Llogari te pagueshme tregtare afatshkurtra

Llogari te pagueshme tregtare afatshkurtra me 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021 paraqiten si me poshte:

	<u>31 dhjetor 2022</u>	<u>31 dhjetor 2021</u>
Furnitore te papaguar	11,675,926	10,043,406
Debitore, kreditore te tjere	56,121	165,792
<b>Totali</b>	<b>11,732,047</b>	<b>10,209,198</b>

Ne kete pozicion perfshihen edhe detyrime ndaj shoqerise ARMO sha per shumen 6,312,329 mijë leke (2021: 6,312,329 mijë leke). Shoqeria ARMO nuk zhvillon me aktivite. Gjithashtu, shoqeria ka edhe te drejta per arketim ndaj kesaj shoqerie ne shumen 11,464,502 mijë leke (2021: 11,464,502 mijë leke), shiko shenimin 11 te ketyre pasqyrave financiare. Te drejtat dhe detyrimet ndaj ARMO sha jane paraqitur ne vlere bruto dhe nuk jane kryer kompensime.

### 24. Llogari te pagueshme te tjera

Llogari te pagueshme te tjera afatshkurtra me 31 dhjetor 2022 dhe 2021 paraqiten si me poshte:

	<u>31 dhjetor 2022</u>	<u>31 dhjetor 2021</u>
Paga personeli	37,215	64,195
Detyrim sigurime shoqerore dhe shendetsore	24,497	23,598
Tatim Fitimi	617,097	244,795
TVSh per tu paguar	62,623	12,031
Tatimi mbi te ardhurat	7,862	12,737
Tatim ne burim	82	421
Renta minerare	40,569	27,314
Gjoha dhe interesa te llogaritura	352,129	352,129
Dividente per t'u paguar	2,881,967	2,882,967
Arketime ne Avance per porosi	177,236	
<b>Totali</b>	<b>4,201,277</b>	<b>3,620,187</b>

### 25. Te ardhura nga aktiviteti i shfrytezimit

Te ardhurat nga aktiviteti i shfrytezimit per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021 paraqiten ne menyre analitike si me poshte:

	<u>31 dhjetor 2022</u>	<u>31 dhjetor 2021</u>
Nga shitja e naftes	4,975,673	4,080,045
Nga shitja e gazit	4,659	4,381
Nga shitja e energjise	1,970,602	1,508,482

Sherbime te tjera	4,138	6,715
<b>Totali</b>	<b>6,955,072</b>	<b>5,599,623</b>

## 26. Puna e kryer nga njesia dhe qe kapitalizohet

Puna kryer nga njesia dhe e kapitalizuar per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021 paraqiten si me poshte:

	<u>31 dhjetor 2022</u>	<u>31 dhjetor 2021</u>
Puna e kryer nga njesia dhe qe kapitalizohet	33,134	26,722
<b>Totali</b>	<b>33,134</b>	<b>26,722</b>

## 27. Te ardhura te tjera

Te ardhurat e tjera per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021 paraqiten si me poshte:

	<u>31 dhjetor 2022</u>	<u>31 dhjetor 2021</u>
Qera e zakonshme	4,867	6,677
Shitje skrapi	824	1,132
Konsum vetjak	424	
Teprica inventari		80
Shitje sherbime	2,094	100
Gjoha,penalitete	6,122	369
Arketim debitoresh		79
Te ardhura te tjera	47,884	40,753
Bonuese	13,955	
Te ardhura nga grandet	795	861
<b>Totali</b>	<b>76,965</b>	<b>50,051</b>

## 28. Lenda e pare dhe materiale te konsumueshme

Lende e pare dhe materiale te konsumueshme per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2022 ne vleren 2,385,481 mijë leke (2021: 1,422,712 mijë leke) paraqet shpenzimet qe kryen per blerje te energjise elektrike, si dhe materiale te tjera te konsumueshme qe nevojiten gjate procesit te prodhimit dhe detajohen si vijon:

	<u>31 dhjetor 2022</u>	<u>31 dhjetor 2021</u>
Shpenzime energji elektrike	2,117,333	1,217,089
Shpenzime materiale	268,148	205,623
<b>Totali</b>	<b>2,385,481</b>	<b>1,422,712</b>

**29. Ndryshimi ne inventarin e produkteve te gatshme dhe prodhimit ne proces**

Ndryshimi i gjendjes se produktit te gatshem dhe prodhimit ne proces per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021 paraqitet si me poshte:

	<u>31 dhjetor 2022</u>	<u>31 dhjetor 2021</u>
Ndryshimi ne inventarin e produkteve te gatshme dhe prodhimit ne proces	1,415,027	(512,528)
<b>Totali</b>	<b>1,415,027</b>	<b>(512,528)</b>

Gjendja e produktit te gatshëm dhe ne proces me:

	<u>2022</u>	<u>2021</u>
Gjendja e produktit me 1 janar	976,809	1,765,694
Gjendja e produktit me 31 dhjetor	1,322,951	976,809
Ulja ne gjendjen e inventarin te produkteve te gatshme dhe prodhimit ne proces	<b>346,142</b>	<b>(788,885)</b>
Rritja e produktit te padorezuar nga kontraktoret HK	1,062,254	271,057
Firo ligjore	6,631	5,300.00
<b>Balanca me 31 dhjetor</b>	<b>1,415,027</b>	<b>(512,528)</b>

**30. Shpenzime personeli**

Shpenzimet e personelit per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021 detajohen si me poshte:

	<u>31 dhjetor 2022</u>	<u>31 dhjetor 2021</u>
Shpenzime per paga	1,336,722	1,467,098
Shpenzime per sigurime shoqerore e shendetesore	195,533	193,447
<b>Totali</b>	<b>1,532,255</b>	<b>1,660,545</b>

Shpenzimet e personelit perbehen nga pagat dhe kontributet e sigurimeve shoqerore e shendetesore. Numri mesatar vjetor i punonjesve per vitin 2022 eshte 1,645 punonjes dhe per vitin 2021 ishte 1,745 punonjes.

**31. Zhvleresimi i aktiveve afatgjata materiale**

Paraqitet efekti neto i renies se vleres se Aktiveve Afatgjata qe ka rezultuar nga vleresimi dhe paraqitja e tyre me vleren e drejte. Gjate vitit 2022 dhe 2021 shoqeria Albpetrol nuk ka kryer testin e zhvleresimit.

**32. Shpenzime të tjera të shfrytëzimit**

Shpenzimet e tjera të Shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021 detajohen si më poshte:

	<b>31 dhjetor 2022</b>	<b>31 dhjetor 2021</b>
Blerje të pastokueshme (solar,vaj kompresori)	5,275	17,205
Trajtime të përgjithshme (llog. 611)(energji,ujë)	1,742	919
Kancelari (llog 651)	2,050	5,611
Shpenzime për objekte dhe mjete me qera(llog. 613)		
Mirembajtje dhe riparime (llog. 615)	328	435
Kerkime dhe studime (llog. 617)	1,325	5,847
Te tjera (llog. 618)(specifiko)	278	470
Shpenzime leje mjedisore 618/2	2,866	2,736
Punime e shërbime nga të tjerë	7,961	134
Shpenzime program financiar	1,089	
Shpenz ruajtje lende radioaktive(6187)	792	864
Shpenz mirembajtj.paisje informatike(6186)	473	3,806
Shpenzime ruajtje objekti	58,555	49,251
Shpenzime kalibrim rez nafte	25	
Shpenzime monitorim mjedisi (6124)		
Konsum vetjak	645	
Personel jashtë njesise(621)	2,384	3,455
Publicitet, reklama (llog. 624)	448	5,654
Transferime, udhetime e dieta (llog. 625)	2,224	1,622
Shpenzime postare e telekom. (llog. 626)	1,649	1,648
Shpenzime transporti për personelin (llog. 627)	20,980	22,051
Shpenzime transporti për materiale (llog. 627/1)	13,317	17,647
Shpenzime për shërbimet bankare (llog. 628)	857	1,517
Shpenzime kontrolli paisje konformiteti (618/4)	2,194	
Shpenzime sig magazina fiskale(6185)	11,335	14,799
Renta minerare 635	498,033	408,443
Siguracion automjetesh	4,405	5,001
Taksa e regjistrimit, kolaudime mjjetesh (635)	4,565	4,637
Takse dhe tarifa vendore (llog 634)	210,117	239,861
Regjistrim pasurie( llog.618/3)		
Taksa për Aktpadi (llog.6331)	4,785	1,939
Sigurim jete dhe pasurie(6184)	18,872	21,700
Shpenzime arbitrazhi(611)	108,798	89,550
Subvencione të dhëna (llog. 653)	399	
Shpenzime për pritje e përfaqësime (llog. 654)	1,544	1,140
Gjoha dhe demshperblime (llog. 657)	96,567	122,681
Shpronësime e cdëmtim mjedisi	5,486	13,542
Shpenzime auditim bilanci dhe të tjera(629)	40,400	129,579
Shpenzime të tjera (llog. 658)	453	686
ndihma ekonomike(655)	8,850	10,390
provizione	2,527,994	300,000
Firo	6,631	5,300
Inventar I imet jashtë përdorimit		10,302
<b>Totali</b>	<b>3,676,691</b>	<b>1,520,422</b>

**33. Te ardhura dhe shpenzime interesi dhe te ngjashme neto**

Te ardhura dhe shpenzime interesi dhe te ngjashme per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021 detajohen si me poshte:

	<u>31 dhjetor 2022</u>	<u>31 dhjetor 2021</u>
Te ardhura nga interesat		(1)
Te ardhura nga konvertimi	6,155	(4,691)
Shpenzime nga konvertimi	(3,661)	4,476
<b>Totali</b>	<b>2,494</b>	<b>(216)</b>

**34. Tatimi mbi fitimin**

Perlogaritja e tatimit mbi fitimin per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021 paraqitet si me poshte:

	<u>31 dhjetor 2022</u>	<u>31 dhjetor 2021</u>
Rezultati para tatimit (Fitimi / Humbje)	486,071	135,446
Shpenzime te panjohura	2,646,463	695,147
Rimarrje provizione		
<b>Rezultati tatimor i ushtrimit (Fitim/ Humbje)</b>	<b>3,132,534</b>	<b>830,593</b>
Tatimi mbi fitimin (15%)	469,880	124,589
<b>Rezultati Financiar neto i periudhes</b>	<b>16,191</b>	<b>10,857</b>

**35. Te ardhura te tjera gjithperfshirese per vitin**

Paraqiten efektet e rivleresimit te Aktiveve Afatgjata. Keto efekte nuk prekin rezultatin e periudhes por fluksojne nepermjet pasqyres se te ardhurave gjithepfshirese. Gjate vitit 2022 nuk ka pasur rivleresime.

**36. Manaxhimi i riskut financiar**

Detyrimet financiare kryesore te Shoqerise perbehen nga llogarite e pagueshme dhe te tjera detyrime. Qellimi kryesor i ketyre detyrimeve financiare eshte te financojne operacionet e Shoqerise dhe te sigurojne garanci per mbeshtetjen e operacioneve. Shoqeria ka hua dhe llogari te arketueshme, mjete monetare dhe depozita afatshkurtra qe sigurohen drejtperdrejte nga operacionet e saj. Shoqeria eshte e ekspozuar ndaj riskut te tregut, riskut te kreditit dhe riskut te likuiditetit.

Drejtimi i larte i Shoqerise mbikeqyr menaxhimin e ketyre risqeve.

**Risku i tregut**

Risku i tregut eshte risku qe vlera e drejte e flukseve monetare te ardhshme te nje instrumenti financiar do te varioje per shkak te ndryshimeve ne çmimet e tregut. Çmimet e tregut perfshijne kater lloje risqesh: risku i normes se interesit, risku i kursit te kembimit, risku i çmimit te mallrave

dhe risqe të tjera të çmimeve, të tilla si risku i çmimit të kapitalit. Instrumentat financiar të prekur nga risku i tregut përfshijnë huatë, kredite dhe depozitat.

### **Risku i normave të interesit**

Risku i normës së interesit përbehet nga risku që vlera e flukseve monetare të ardhshme të një instrumenti financiar do të variojë për shkak të ndryshimeve në normat e interesit në treg dhe riskut që maturitetet e aktiveve që mbartin interes të ndryshojnë nga maturitetet e detyrimeve që mbartin interes të përdorura për të financuar ata aktive. Zgjatja kohore përgjate të ciles norma e interesit e një instrumenti financiar është fikse, përcakton se në çfarë mase është e ekspozuar ndaj riskut të normës së interesit.

### **Risku i kreditit**

Risku i kreditit është risku që një palë tjetër nuk do të jetë në gjendje të paguajë detyrimet e saj që rrjedhin nga një instrument financiar ose marrëveshje klienti, duke çuar kështu në një humbje financiare. Shoqëria është e ekspozuar ndaj riskut të kreditit për shkak të aktiviteteve operacionale të saj (pikë së pari prej llogarive të arketueshme) dhe prej aktiviteteve të saj financiare, që përfshijnë depozitat me bankat dhe institucionet financiare, transaksionet në monedha të huaja dhe instrumenta të tjere financiare.

Risku i kreditit është i kufizuar në vlerën kontabel të aktiveve financiare në datën e raportimit.

Provizionet për kërkesat tregtare të vonuara njihen duke u bazuar në vlerësimet e shumave të parikuperueshme në baze të eksperiencës së mëparshme në mosarëtim nga klientët dhe një analize e pozicionit financiar të palës tjetër. Shoqëria vlerëson rrezikun e cilesise së kreditit të debitorëve dhe vlerëson limitet e kreditit sipas secilit prej tyre.

### **Risku i Likuiditetit**

Risku i likuiditetit është risku që Shoqëria mund të mos jetë në gjendje të paguajë detyrimet e saj të lidhura me detyrimet financiare në momentin e pagesës. Risku i likuiditetit është riski qenësishëm në biznesin e Shoqërisë pasi disa aktive specifike të blera apo detyrime të shitura mund të kenë karakteristika likuiditeti që janë specifike. Nëse Shoqërisë do t'i duhet të ketë shuma të mëdha në një afat të shkurtër kohor që tejkalojnë kërkesat normale për mjete monetare mundet që të ndeshet me vështirësi për të siguruar çmime konkurruese. Shoqëria menaxhon riskun e likuiditetit duke monitoruar në mënyrë të vazhdueshme parashikimet dhe flukset monetare aktuale dhe duke u munduar të përputhe profilet e maturitetit të aktiveve dhe detyrime.

	2022	0-12 muaj	1-5 vjet	Me tepër se 5 vjet	Totali
<b>Aktive financiare</b>					
Mjetet Monetare dhe të Ngjashme		1,476,592			1,476,592
Llogaritë e arketueshme		1,659,836	1,081,157	17,593,504	20,334,496
<b>Aktive financiare gjithsej</b>		<b>3,136,428</b>	<b>1,081,157</b>	<b>17,593,504</b>	<b>21,811,088</b>
<b>Detyrime financiare</b>					
Llogaritë e pagueshem dhe detyrime të perlllogaritura		215,135	1,125,642	10,391,270	11,732,047



	2022	0-12 muaj	1-5 vjet	Me teper se 5 vjet	Totali
Detyrime ndaj personelit		37,215			37,215
Detyrime ndaj Shtetit dhe ISSH		752,730	352,129		1,104,859
Huamarrje afatshkurter		71,786			71,786
Huamarrje afatgjata			34,250		34,250
Grante				61,714	61,714
<b>Detyrime financiare gjithsej</b>	<b>1,076,866</b>	<b>1,512,021</b>	<b>1,512,021</b>	<b>10,452,984</b>	<b>13,041,871</b>
<b>Hendeku i maturitetit</b>	<b>2,059,562</b>	<b>-430,864</b>	<b>-430,864</b>	<b>7,140,519</b>	<b>8,769,217</b>

	2021	0-12 muaj	1-5 vjet	Me teper se 5 vjet	Totali
<b>Aktive financiare</b>					
Mjetet Monetare dhe te Ngjashme		547,025			547,025
Llogarite e arketueshme		1,688,566	1,971,731	16,593,161	20,253,459
<b>Aktive financiare gjithsej</b>	<b>2,235,591</b>	<b>2,235,591</b>	<b>1,971,731</b>	<b>16,593,161</b>	<b>20,800,484</b>

**Detyrime financiare**

Llogarite e pagueshem dhe detyrime te perlllogaritura	446,186	1,123,981		8,639,032	10,209,199
Detyrime ndaj personelit	64,195				64,195
Detyrime ndaj Shtetit dhe ISSH	285,439	352,129			637,568
Huamarrje afatshkurter	172,310				172,310
Huamarrje afatgjata		43,046			43,046
Grante				62,510	62,510
<b>Detyrime financiare gjithsej</b>	<b>968,130</b>	<b>1,519,155</b>	<b>1,519,155</b>	<b>8,701,541</b>	<b>11,188,827</b>
<b>Hendeku i maturitetit</b>	<b>1,267,461</b>	<b>452,576</b>	<b>452,576</b>	<b>7,891,620</b>	<b>9,611,657</b>

**Risku i monedhes**

Shoqeria ndermerr transaksione ne monedhe te huaj si pasoje e ekspozimit ndaj luhatjeve te kurseve te kembimit. Ekspozimi ndaj kurseve te kembimit manaxhohet duke percaktuar nje politike midis te arketueshmeve dhe te pagueshmeve. Vlera kontabel neto e aktiveve dhe detyrimeve monetare te shoqerise sipas monedhave per vitin qe u mbyll jane paraqitur ne tabelen e meposhtme.

	2022	LEK	EUR	USD	GBP	Totali
<b>Aktive financiare</b>						
Mjetet Monetare dhe te Ngjashme		1,476,594	-27	-26		1,476,592
Llogarite e arketueshme		20,303,660	69	30,767		20,334,496
<b>Aktive financiare gjithsej</b>	<b>20,780,254</b>	<b>20,780,254</b>	<b>41</b>	<b>30,793</b>		<b>21,811,088</b>
<b>Detyrime financiare</b>						
Llogarite e pagueshem dhe detyrime te perlllogaritura		11,727,919	1	4,127		11,732,047
Detyrime ndaj personelit		37,215				37,215
Detyrime ndaj Shtetit dhe ISSH		1,104,859				1,104,859
Huamarrje afatshkurter		203	71,583			71,786

